



Projekt i financuar nga
Bashkimi Evropian



STUDIM VLERËSUES

2017

*Rastet e konflikteve ujore
të lidhura me zhvillimin e hidroenergjisë
në Shqipëri*



Partnerët e projektit të HELP-CSO janë:



Projekti u zbatua në kuadër të ACHIEVE



Zbatuar nga REC Shqipëri



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian

STUDIM VLERËSUES

Rastet e konflikteve ujore
të lidhura me zhvillimin e hidroenergjisë
në Shqipëri

2017



Cover: Pamje e luginës së lumit Vjosa.

© Eco Albania

Botues: **©HELP-CSO**
Datë: Shkurt, 2017
Autor: **Milieukontakt Albania**
Lex Ferenda
Eco Albania

Përgatiti
dhe hartoi: **M.Sc. Elton Qendro**

Me kontributin:
*Valbona Mazreku, Arion Sauku, Besmir Beja, Odeta Jahaj,
Olsi Nika, Besiana Guri, Agim Blloshmi, Erdiola Terziu,
Daniel Bica, Robert Murataj.*

Kontakt: info@help-cso.net

Dizajn dhe faqosje: A. Hitoaliaj

MOHIM

Përmbytja e këtij botimi është përgjegjësi e Milieukontakt Shqipëri, Lex Ferenda dhe Eco Albania, si partner zbatues të projektit "HELP-CSO" dhe në asnjë rast nuk reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe/ose REC Shqipëri.

Në lidhje me informacionin e paraqitur në këtë botim, HELP-CSO ose punonjësit dhe anëtarët e saj nuk dalin garant në formë të shprehur ose të nënkuptuar dhe nuk japin garanci për komercialitetin dhe përshtatshmërinë për qëllime të caktuara, si dhe në asnjë rast HELP-CSO nuk mban përgjegjësi ligjore ose përgjegjësi për saktësinë, perfeksionin apo përdorimin e informacionit, produktit dhe shpjegimeve, dhe HELP-CSO nuk garanton që përdorimi i tij nuk do të shkelë të drejtat e siguruara të autorit.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1. HYRJE

- 1.1 Analiza e situatës
- 1.2 Objektiva dhe qëllimi i studimit
- 1.3 Kufizimi i studimit

2. METODOLOGJIA E STUDIMIT

- 2.1 Kuadri metodologjik
- 2.2 Strategjia e mbledhjes së të dhënave
 - 2.2.1 Mbledhja e të dhënave për krijimin e një liste fillestare të konflikteve ujore
 - 2.2.2 Rishikimi i literaturës.
 - 2.2.3 Identifikimi i rasteve studimore dhe informuesit kryesorë.
 - 2.2.4 Puna në terren në komunitetet e prekura nga konflikti.
 - 2.2.5 Sistemimi, kontrolli i cilësisë, analiza, interpretimi i rezultateve dhe përpilimi i studimit

3. ANALIZA E REZULTATEVE

- 3.1 Shkaqet e konfliktit
- 3.2 Gjeografia e konfliktit
- 3.3 Mobilizimi i konfliktit
- 3.4 Ndikimi i konfliktit
- 3.5 Rezultati i konfliktit

4. DISKUTIMET E REZULTATEVE

5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

REFERENCA

SHTOJCA

- Shtojca 1: Databaza e konflikteve ujore të lidhura me hidrocentralet
- Shtojca 2: Lista e aktorëve të konsultuar
- Shtojca 3: Foto të marra nga projekte të ndryshme hidrocentralesh
- Shtojca 4: Fakt-Fletë informuese të konflikteve ujore të lidhura me hidrocentralet

LISTA E TABELAVE

Tabela 1:	Tabela e viktimave dhe njerëzit e arrestuar lidhur me konfliktet e HEC-eve
Tabela 2:	Përmbledhje e HEC-ve në Shqipëri sipas kategorive
Tabela 3:	Struktura e pyetësorit dhe statistikat

LISTA E FIGURAVE

Figura 1:	Procesi ciklik i fushave kërkimore
Figura 2:	Hapat metodikë për studimin dhe vlerësimin e konflikteve ujore
Figura 3:	Cili është shkaku i konfliktit
Figura 4:	Njerëzit e prekur
Figura 5:	Mbështetësit kryesorë në rastet konfliktuale
Figura 6:	Harta e lidhur me hidrocentralet konfliktuale.
Figura 7:	Fillimi i mobilizimit
Figura 8:	Grupet e mobilizuara
Figura 9:	Forma e mobilizimit komunitar
Figura 10:	Ndikimi mjedisor i konfliktit
Figura 11:	Ndikimi shëndetësor
Figura 12:	Ndikimi socio-ekonomik i konflikteve të lidhura me hidrocentralet
Figura 13:	Statusi aktual i projekteve
Figura 14:	Statusi i konfliktit
Figura 15:	Suksesi i drejtësisë mjedisore

SHKURTIMET

AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
ACHIEVE	Shoqëria Civile Shqiptare për një Mjedis Evropian
EJOLT	Organizatat e Drejtësisë Mjedisore, Përgjegjësisë dhe Tregtisë
BE	Bashkimi Evropian
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
HEC	Hidrocentral
HELP-CSO	Promovimi i Forcimit të Legjislacionit Horizontal të Organizatave të Shoqërisë Civile
KKU	Këshilli Kombëtar i Ujërave
Kwh	Kilovat orë
MEI	Ministria e Energjisë dhe Industrisë
MM	Ministria e Mjedisit
MW	Megavat
N/A	i Pa Aplikueshëm
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky studim është përgatitur në kuadër të projektit “Forcimi i Legjislacionit Horizontal dhe Promovimi i OSHC-ve”, (HELP-CSO), financuar nga BE-ja, përmes Programit ACHIEVE që menaxhohet nga Qendra Rajonale e Mjedisit në Shqipëri dhe zbatohet nga Milieukontakt Shqipëri, Eko Albania dhe Lex Ferenda.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është mbështetja e organizatave mjedisore për zbatim dhe monitorim më të mirë të legjislacionit horizontal në vend. Objektivi parësor i këtij studimi është të vlerësojë konfliktet ujore të lidhura me zhvillimin e hidroenergjisë në vend. Ky vlerësim bazohet në të dhënat e grumbulluara sipas modelit

të vlerësimit të Organizatave të Drejtësisë Mjedisore, Përgjegjësisë dhe Tregtisë (EJOLT). Gjetjet e paraqitura në këtë studim kanë për qëllim të japin informacion mbështetës për një planifikim të detajuar të aktiviteteve të projektit HELP-CSO, siç është harta ndër aktive e konflikteve, si dhe njëkohësisht të mbështesë organizatat mjedisore vendore, komunitete vendore, qytetarët aktivë, shkencëtarët, fermerët dhe kompanitë energjetike që të përmirësojnë menaxhimin e rasteve konfliktuale lidhur me hidrocentralet në vend.

Ky studim vlerësues nxori në pah **18 raste** të sigurta konfliktesh të lidhura me hidrocentralet që janë raportuar në Shqipëri gjatë periudhës 2012-

Emri i HEC	Nr. i personave të arrestuar/shoqëruar	Viktimat / të plagosurit
HEC Gojan	N/A	1 (plagosje)
HEC Fangu	6	3 (vdekje)
HEC Cernaleva	4 (3 gra +1 mitur)	N/A
HEC Ternova	8	N/A
HEC Vinjoll (Hurdhas 1,2,3)	2	1 (vrasje)
HEC Dragobi	2	N/A
HEC Gurshpate 1,2	8 (3 gra)	N/A
HEC Peshku	N/A	1 (tentativë vrasjeje)
HEC Kalivaç	4 arrestuar	
Totali	34	6

Tabela 1:
Viktimat e konflikteve dhe personat e arrestuar lidhur me konfliktet e HEC-eve

2016. Siç shihet në Tabelën 1, këto 18 konflikte kanë rezultuar në 34 persona të arrestuar dhe / ose të shoqëruar, mes të cilëve 6 gra dhe 1 i mitur, si edhe 6 viktime të lidhura ngushtë me projektet e hidrocentraleve. (3 viktime nga aksidente në punë; 1 viktimë nga konflikti i lindur nga ndërtimi HEC-it; 1 i plagosur dhe 1 tentativë vrasjeje).

Studimi zbuloi se hidrocentralet e vegjël janë gjeneruesit kryesorë të konflikteve.

Në asnjë nga rastet konfliktuale të identifikuar, palët (kompanitë koncesionare energjetike, komunitete dhe qeveria) nuk kanë arritur në marrëveshje zyrtare bashkëpunimi për shkak të protestave, kundërshtive nga banorët vendas. Konfliktet kanë pasur ndikim domethënës në ndërtimin/shfrytëzimin e hidrocentraleve, pasi në 1/3 të 18 rasteve, përplasjet me komunitetin kanë shkaktuar ndërprerje ose vonesa në punimet e ndërtimit, duke sjellë humbje financiare.¹

Në të gjitha rastet e konflikteve të analizuar, grupet më të cënuara janë **zonat rurale, fshatrat e vegjël ose komunitetet** ku jetesa është ngushtësisht e lidhur me burimet ujore. Transformimi apo përvetësimi i territorit dhe ekosistemit nga përdorues të rinj (*shoqëritë koncesionare energjetike*) i kanë zhvendosur dhe iu kanë hequr të drejtën tradicionale të përdorimit të ujit dhe kanë kërcënuar shtresa të ndryshme të shoqërisë dhe kohezionit social.

Të drejtat e ndarjes së ujit dhe ujit për vaditje përbëjnë shkakun kryesor që çojnë në konflikte ujore të lidhura me zhvillimin e hidrocentraleve në vend. Mungesa e informimit dhe konsultimit publik është shkak kryesor në 21% të rasteve konfliktuale, ndjekur nga humbja e peizazhit dhe përkatësisë së vendit. 52% të intervistuarve deklarojnë se komunitetet vendore/fermerët dhe fshatarët janë grupi më i prekur nga hidrocentralet konfliktuale. Sipas të intervistuarve, në 67% të rasteve, mobilizimi ishte reagim i fillimit të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve, pasi panë makineritë që filluan gërmimet në vend. Ky shkak përputhet ngushtë me mungesën e informimit dhe konsultimit publik në shumicën e projekteve të hidrocentraleve.

Nga ana tjetër, ndikimi i konfliktit manifestohet ndryshe nga grupet e prekura: organizatat mjedisore fokusohen te humbja e peizazhit, biodiversitetit dhe përmbytjet, ndërsa zonat rurale dhe komunitetet te mungesa e ujit për vaditje dhe bujqësisë në 54% të rasteve. Grupet e prekura nuk janë shumë optimistë nga rezultati i konfliktit ku 64% e të intervistuarve deklaruan se rastet nuk ishin të suksesshme. Megjithatë, ata pranuan faktin se ka patur një forcim të informimit publik dhe pjesëmarrjes publike në çështjet e zhvillimit të hidrocentraleve si rezultat i angazhimit në konflikte. Të intervistuarit bënë një sërë rekomandimesh për një analizë të thellë të ndikimit mjedisor dhe përfitimit lokal nga zhvillimi i hidrocentraleve dhe theksuan nevojën e forcimit të monitorimit të përdorimit të ujit nga kompanitë energjetike. Autori është i mendimit se ka një nevojë të menjëherëshme për të gjithë grupet e aktorëve si, kompanitë koncesionare energjetike, organizatat vendore dhe grupet komunitare për ta ndryshuar strategjinë e tyre të angazhimit dhe “suksesit” nga situata tradicionale “humb-fito” drejt një situatë “fito-fito”.

Kjo do të mundësonte përmirësimin e projekteve në fazën e ndërtimit, do të monitoronte ndarjen e ujit gjatë operimit dhe do të shmangte gjenerimin e konflikteve të ardhshme.

Analiza e këtij studim dëshmoi se kategorizimi i rasteve konfliktuale të ndryshme është i vështirë kur vlerësimi referohet nga njerëz të ndryshëm. Kjo lidhet dhe me faktin që EJOLT-i është një metodologji vlerësimi cilësore e bazuar në “gjykimin e ekspertizës” i cili është i prirur për gabime dhe tendencë anshmërie. Kjo duket në veçanti në lidhje me vlerësimin e gjeografisë të konfliktit dhe ndikimit të rasteve konfliktuale të cilat më pas u përkthyen në fletë informuese² individuale, pavarësisht përpjekjes së ekspertit dhe partnerëve HELP-CSO për të promovuar përdorimin e të dhënave sasiore tek aktorët e intervistuar. Në këtë vështrim rezultatet e paraqitura në studimin vlerësues duhet të interpretohen me kujdes, veçanërisht në lidhje me analizën e fletëve informuese të konflikteve.

¹ HEC Gojan u hodh në erë me eksploziv; HEC Vinjollë (Gallate) u shpërthye me eksploziv; HEC ternova dhe HEC Cernaleve pësuan shkatërrim të aseteve dhe pezullim të punimeve.

² Shënim i përkthyesit: Fletë informuese qëndron për përkthimin e “Factsheet” nga anglishtja.

1. HYRJE



1

1.1 Analiza e situatës

Shqipëria është një vend me varësi energjetike dhe aktualisht prodhon 40-50% të nevojës së brendshme të elektricitetit në varësi të reshjeve vjetore. Pjesa tjetër e nevojës plotësohet nga importi nga rajoni duke qenë një vend me varësi të lartë importi në rajon. Ndërsa në anën tjetër Shqipëria zotëron potencial të lartë hidrik dhe aktualisht është duke eksploruar vetëm 45% të kapacitetit të saj. (AKBN: 2016)³

Në këtë situatë, Shqipëria është orientuar në licencimin e projekteve hidroenergjetike përmes marrëveshjeve koncesionare në mënyrë të përshpejtuar. Në kohën e realizimit të studimit janë

identifikuar 183 marrëveshje koncesionare të firmosura nga qeveria për ndërtimin e 524 hidrocentraleve. Shumica e hidrocentraleve janë me kapacitet të vogël ose HEC-e të vegjël dhe janë licencuar gjatë periudhës 2002-2016. Nga këto shifra, 177 HEC-e janë në operim dhe licencuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE); 43 HEC-e janë në ndërtim dhe 364 HEC-e janë të planifikuara nga ministria e energjisë por nuk kanë filluar akoma ndërtimin.⁴

Siç tregohet në Tabelën 2, numri i koncesioneve i lëshuar në 2009 dhe në 2013 është rritur ndjeshëm dhe korrespondon me zgjedhjet parlamentare të viteve përkatës.

Viti i koncesionit	# i koncesioneve	# i HEC-eve	HEC-et në prodhim	HEC-et në ndërtim	Planifikuar	HEC-et e kontestuar
1997	1	1	1	0	0	0
2002	2	23	23	0	0	0
2003	8	8	8	0	0	0
2004	1	1	1	0	0	0
2005	1	2	2	0	0	0
2006	0	0	0	0	0	0
2007	3	4	3	0	0	0
2008	27	43	23	14	0	0
2009	55	177	13	15	0	0
2010	6	18	0	5	0	0
2011	14	52	6	5	0	1
2012	11	42	57	0	0	1
2013	46	130	12	0	0	1
Nëntotal 1	175	501	149	39	0	3
2014	1	1	13	0	0	6
2015	2	8	15	0	0	4
2016	6	14	0	4	0	5
Nën total 2	9	23	28	4	0	15
Grant totali	184	524	177	43	364	18
*Autori nuk mundi të sigurote të dhëna të besueshme të ndara sipas viteve.						
Burimi: AKBN, MEI, EITI, ERE, KKK, MM, 2016						

Tabela 2
Përmbledhje e hidrocentraleve në Shqipëri sipas kategorisë dhe statusit

³ Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore 2016; www.akbn.gov.al

⁴ Shqipëria ka një regjistër publik të hidrocentraleve i menaxhuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Megjithatë, informacioni që gjendet në regjistër nuk është i plotë dhe i përditësuar. Me qëllim aksesin e të dhënave në lidhje me hidrocentralet, duhet kërkuar dhe referuar burimeve dhe raporteve të shpërndara siç është Enti Rregullator i Energjisë dhe VKM të qeverisë. Megjithatë, disa burime dhe raporte që përmbajnë informacion rreth koncesioneve dhe prodhimit të elektricitetit janë publikuar, informacioni që gjendet në to nuk është i plotë. Shpesh është shumë e vështirë të identifikosh detaje rreth një hidrocentrali siç mund të jetë vendndodhja, emri i hidrocentralit, apo emrat e aksionarëve që kanë fituar koncesionin. Shpesh kompanitë fituese nuk janë ato menaxhere pas një sërë shitjesh dhe ri-shitjesh të koncesioneve. Shifrat e paraqitura i referohen AKBN të cilat u shqyrtuan nga eksperti në 7 tetor 2016.

Shumica e hidrocentraleve të pa eksploruara akoma ndodhen në zona me ndjeshmëri të lartë mjedisore dhe sociale, në zona të mbrojtura natyrore dhe në toka të banuara nga komunitete vendore. Në Shqipëri pasojat negative sociale dhe mjedisore kanë shkaktuar debate, kundërshtime, konflikte, protesta dhe padi në lidhje me hidrocentralet. Arsyeja kryesore lidhet me faktin se asnjë vend i shenjtë, park apo lumë nuk është lënë i paprekur nga ky shpërthim koncesionesh.

Ky studim përpiket të evidentojë në masën më të mundshme projektet e kundërshtuara, shkaku dhe kundërshtisë, ndikimin që ato krijojnë dhe rezultatin e konfliktit.

Në këtë studim, do të përshtatim përkufizimin e Ashton për konfliktet ujore:

“[në] kuptimin më të thjeshtë dhe të gjerë, termi “konflikt ujor” është përdorur për të përshkruar çdo mosmarrëveshje, kundërshti dhe konflikt mbi dhe për ujin, ku ndërhyrja sociale, politike, ekonomike dhe policore është nevojitur, ose do të kërkohet, për të zgjidhur problemin”.
(Ashton, 2000, fq. 69-70)⁵

Faktet dëshmojnë se komunitete vendore mbartin kosto jo proporcionale të shumë prej këtyre projekteve të cilat së shumti kryhen pa konsultimin e tyre, duke iu privuar komuniteteve mundësinë të ndikojnë për pasojat ose të përfitojnë kompensim. Ndërveprimi i dobët i komuniteteve vendore me autoritetet shtetërore e rrit rrezikun që banorët të lihen jashtë këtyre negociatave.

Me qëllim që të avancohen njohuritë për këto çështje, u ndërmor ky studim hartëzimi për të përcaktuar karakteristikat e konfliktit ujor që buron ndërmjet qeverisë, hidrocentraleve dhe banorëve vendas. Raportimi i pasojave shkatërruese nga kompanitë e hidrocentraleve, mbi ekosistemet ujore në zona mjedisore të ndjeshme dhe në ato

zona të cilat banohen nga komunitete vendore janë shndërruar në sfidën kryesore për ushtrimin e të drejtës së njerëzve për informim dhe konsultim, ndikimin e rezultatit apo përfitimin e kompensimit.

Varësia tek burimet ujore dhe me raste marrëdhënia “dalluese kulturore” me ujin dhe humbja e aksesit në këto burime ka ndikime të shumëllojta për banorët vendas. Në një numër domethënës rastesh, tensioni për çështjet e ujit të banorëve ka stisur konflikte, që kanë përshkallëzuar në faza shkatërruese duke përfshirë humbjen e jetës.⁶ Njëkohësisht, këto konflikte kanë kosto për industrinë në aspektin e reputacionit, koston së financimit, operacionit të ndërtimit, humbjen e licencës sociale të kompanisë dhe shkaktimin e vonesave, rirregullimit dhe madje anulimin e projekteve.

Ky studim mundëson parashikimin e trendit kombëtar rreth pretendimeve konkurruese mbi përdorimin e ujit, llojin dhe gjeografinë e konfliktit, efektet dhe rezultatet që këto konflikte shkaktojnë për banorët vendas, qeverinë dhe industrinë.

1.2 Objekti dhe qëllimi i studimit

Ky studim është përgatitur nga eksperti në emër të partnerëve të projektit “Promovimi i Forcimit të Legjislacionit Horizontal (HELP-CSO)” i cili përbëhet nga Milieukontakt Shqipëri, Eco Albania dhe Lex Ferenda në kuadër të programit ACHIEVE menaxhuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit në Shqipëri dhe financiar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri.

Objekti i përgjithshëm i projektit është mbështetja e OSHC-ve në promovimin e zbatimit të legjislacionit horizontal mjedisor duke rritur kapacitete e tyre përmes trajnimeve, ekspertizës dhe advokimit. Studimi vlerësues *identifikimi i konflikteve ujore të lidhura me hidrocentralet në Shqipëri* është një prej aktiviteteve të projektit i cili do të rezultojë në përgatitjen e një regjistri të

⁵ Sipas Ashton (2000) uji është një e “e mirë e përbashkët”, pasi rrjedh në mënyre natyrale nga një vend në tjetrin duke e bërë të vështirë krijimin e pronësisë mbi të. Mënyra më e mirë për menaxhimin e kësaj “të mire të përbashkët” është përmes bashkëpunimit të shumë prej përdoruesve. Megjithatë, një rritje e konkurrencës mbi përdorimin e ujit për shkak të popullsisë dhe ose aktivitetit njerëzor mund të çojë drejt tensionit dhe konfliktit ndërmjet përdoruesve të ujit ose aktorëve, ku nga këndvështrimi i Ashton dhe të tjerëve (UNESCO dhe Kryqi i Gjelbër Ndërkombëtare, dhe Stuart 1996) destabiliteti, tensioni dhe konflikti ndërmjet përdoruesve ët ujit janë kushtet kryesore për “konfliktet ujore”.

⁶ Rasti i HEC Gojan që u shpërthe me tritol apo rasti i HEC Vinjoll.

konflikteve ujore dhe një listë me fletë informuese për hidrocentralet konfliktuale. Kjo më pas do ti shërbejë projektit HELP-CSO për të ndërtuar një hartë ndër aktive për hidrocentralet konfliktuale me akses të hapur për publikun. Studimi do të bazohet mbi metodologjinë EJOLT për drejtësinë mjedisore.

1.3 Kufizimet e studimit

Ky studim nuk pretendon paraqitjen e një panorame të plotë të gjithë hidrocentraleve konfliktuale në vend, por në gjykimin dhe besimin më të mirë të mundshëm të ekspertit studimi mundëson për herë të parë një burim publikisht të disponueshëm që tenton të sjellë sëbashku të

dhëna nga burime të shumta në lidhje me konfliktet ujore për hidrocentralet në Shqipëri.

Eksperti pati një numër të kufizuar ditësh dhe kohe dhe u ndesh me boshllëqe pa fund për shkak të mungesës së të dhënave publike, shpesh kontradiktore dhe të pasakta, publikate të emrave të projekteve dhe koncesioneve, emra të ndryshëm për projekte të njëjta dhe informacione kundërshtuese për hidrocentralet që janë në zona të mbrojtura. Megjithatë, eksperti u mundua të paraqesë situatën në mënyrë sa më të saktë dhe beson se regjistri i konflikteve të hidrocentraleve dhe përpilimi i fletëve informuese të projekteve sigurojnë panoramën e tendencës së konflikteve kryesore.

2. METODOLOGJIA E STUDIMIT



2

2.1 Kuadri metodik

Metodologjia e studimit u udhëhoq nga modeli i Organizatave të Drejtësisë Mjedisore, Përgjegjësisë dhe Tregtisë (EJOLT), i përgatitur nga një grup prej 23 universitetesh dhe krijuar në kuadër të Programit të Shtatë Kuadër (7FP) mbështetur nga Komisioni Evropian që zgjati nga 2011-2015.⁷

Metoda e EJOLT është e bazuar mbi parimin e nënvizimit të shkaqeve për rritjen e shpërndarjes së konflikteve ekologjike në shkallë të ndryshme dhe si ti shndërrojë këto konflikte drejt qëndrueshmërisë mjedisore.⁸

Procesi fillon me të kuptuarin e shkakut të

reagimin e tyre ndaj konfliktit. Faza e ndikimit të konfliktit është e shoqëruar me dëmin ekonomik, ndikimin mjedisor dhe efektet sociale dhe shëndetësore. Procesi përfundon me rezultatin e konfliktit i cili është i fokusuar në statusin dhe pasojat e historisë së konfliktit.

Përgjithësisht, metodologjia kërkimore synon krijimin e një qarku reagimesh ndërmjet:

- a) mbledhjes së informacionit të hapur publik për gjithë rastet e konflikteve ujore,
- b) hulumtimit në zyrë për krijimin e pyetjes kërkimore të studimit,
- c) përgatitjes së pyetësorit, shpërndarjes dhe plotësimit nga grupet e organizatave të shoqërisë civile,

Figura 1:
Procesi ciklik i fushës kërkimore



konfliktit, nxitësit dhe arsyet e tij, aktorët e përfshirë dhe mbështetësit. Më pas avancohet me gjeografinë e konfliktit për të kuptuar vendndodhjen e saktë të konfliktit, natyrën e komuniteteve të përfshirë, origjinën e investitorëve të përfshirë dhe basenin ujor. Metoda vazhdon me formën e mobilizimit gjatë konfliktit për të kuptuar nxitësit, grupet e përfshirë, mbështetësit dhe

- d) intervistave me informatorët kryesorë për çështjet e përzgjedhura,
- e) kontrollin e cilësisë për të bashkërenduar gjithë informacionin e mbledhur,
- f) përpilimi i raportit dhe fletëve informuese përkatëse të rasteve konfliktuale.

Skema më poshtë ilustron më së miri hapat metodologjikë.


⁷ EJOLT mbështet punën e Organizatave të Drejtësisë Mjedisore, duke bashkuar shkencëtare, organizatat aktiviste, qendrat kërkimore, politikë-bërësit nga fushat e mjedisit, ligjit, shëndetit mjedisor, ekologjisë politike, ekonomisë ekologjike për të folur rreth çështjeve të lidhura me shpërndarjen ekologjike. Konceptet qendrore janë borxhi ekologjik ose përgjegjshmëria mjedisore dhe shkëmbimi i pabarabartë Ekologjik.

Gjendet në:

<http://www.ejolt.org/project/>.

⁸ Po aty.

STUDIM VLERËSUES



INFOGRAFIKA KOHORE

2.2 Strategjia e mbledhjes së të dhënave

Përmes hulumtimit në zyrë, shpërndarjes së pyetësorit, intervistave të thella dhe analizave empirike të rasteve, studimi kërkon të eksplorojë të kuptuarit e shkaqeve të konfliktit - ndikimet negative të tipologjive të konfliktit dhe mobilizimin e komuniteteve lokale. Në këtë kontekst, mbledhja e të dhënave u realizua përmes përdorimit të instrumenteve kërkimore cilësore (pyetësor, vizita në terren) dhe sasiorë (hulumtimi në zyrë, shqyrtimi i literaturës). Arsyetimi për zbatimin e metodologjive të shumta kërkimore qëndron në qëllimin e arritjes të kuptuarit të thellë së problemeve që paraqiten dhe kapërcimit të sfidës në mbledhjen e informacionit të nevojshëm.

2.2.1 Mbledhja e të dhënave për krijimin e një liste paraprake të konflikteve ujore.

Eksperti e nisi mbledhjen e të dhënave me monitorimin e medias elektronike dhe asaj të shkruar, raporteve të shumta investigative dhe komunikatave të shtypit të policisë së shtetit me qëllim krijimin e një regjistri të konflikteve ujore. (*Ju lutem shikoni Shtojcën 1*) Hartëzimi i konflikteve ujore u bazua në të dhëna të ngjarjeve të grumbulluara nga informacioni i hapur publik. Këto të dhëna çuan në identifikimin e një regjistri reference që më pas u përkthye në regjistrin paraprak të rasteve të konflikteve ujore.

2.2.2 Shqyrtimi i literaturës.

Shqyrtimi i literaturës për konfliktet ujore përfitoi nga puna e mëparshme siç ishte “Alternativa mjedisore e hidrocentraleve të vegjël në Shqipëri” përgatitur nga një grup ekspertësh, duke përfshirë autorin. [Qëndro, E., M.S.c, Shumka S., Prof et.al; 2015]⁹ Shqyrtimi i literaturës u

ndërmor me pikësynimin për të kuptuar se çfarë mësimi institucionale mund të nxjerrin grupet e përfshirë në konflikte ujore (fermerët, OSHC-të, industrinë private, qeveria) që mund të çojë në ndryshime për adresimin e problemeve të ngritura. Në të njëjtën kohë, shqyrtimi i literaturës pati si qëllim studimin nëse ekzistonin lidhje ndërmjet shkaqeve të konflikteve dhe ide të reja për adaptimin e konflikteve të njëjta të ndeshura në situata dhe vendndodhje të tjera. Kështu që, eksperti krijoi informacion të shumtë që më pas ndihmoi në zhvillimin e kuadrit konceptual të studimit.

2.2.3 Identifikimi i rasteve studimore dhe informuesit kryesorë.

Ky ishte elementi më thelbësor dhe më sfidues. Arsyetimi për zgjedhjen e një rasti të konfliktit ujor për këtë studim, u bazua duke ndjekur një përkufizim të saktë se çfarë është një konflikt ujor sipas shpjegimit nga Ashton (Ashton, 2000, fq,69-70)

Me qëllim identifikimin e saktë të rasteve konfliktuale, eksperti përpiloi një pyetësor të ndërtuar në pesë (5) seksione kryesore sipas pesë fushave kërkimore i cili ishte dhe instrumenti thelbësor në përcaktimin e rasteve konfliktuale. Në secilin prej seksioneve u renditën një sërë pyetje kontrolluese me qëllim adresimin e boshllëkut të informacionit nga puna hulumtuese dhe të dhënave konfuze që paraqiteshin nga të dhënat publike si raportimi në media, të grumbulluara në seksionin 2.2.1. Një informacion i detajuar statistikor i pyetësorit është prezantuar në *Tabelën 2*.

Faza e konflikteve ujore	# i pyetjes	# total i pyetjeve	% në total e # të pyetjeve
Shkaqet	10,11,12	3	13%
Gjeografia	1,2,3,4,5,6,7,8,9	9	39.3%
Mobilizimi	13,14,15	3	13%
Ndikimi	16,17,18	3	13%
Rezultati	19,20,21,22,23	5	21.7%
Shuma	23	23	100%

Table 3

Struktura e pyetësorit dhe statistikave

⁹Qëndro, E., M.S.c, Shumka, S., Prof, Leskoviku, A., Mazreku, V., Cela, E., & Buzi, B. (n.d.), 2015 - Alternativa mjedisore e hidrocentraleve të vegjël në Shqipëri, Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Shqipëri, Tiranë, shtator 2015.

Pyetësi u testua për të adresuar ndonjë pyetje konfliktuale apo mospërputhje dhe u shpërnda përmes e-mailit te 40 organizata mjedisore, ekspertë mjedisore dhe qytetarë të angazhuar në fushën përkatëse. Njëkohësisht pyetësi u publikua *on-line* për një periudhë 3 mujore nga 1 korrik-u deri në 30 shtator, me qëllim mbledhjen e sa më shumë informacioneve mbi projektet e kontestuara. Autori, përmes ndihmës së projektit HELP-CSO mundësoi shpërndarjen e pyetësorëve të printuar gjatë organizimit të tre (3) trajnimeve të mbajtura në kuadër të projektit në Përmet, Librazhd dhe Kukës.

ekologjike si u përjetuan nga aktorët e përfshirë drejtpërsëdrejti në konflikt - eksperiencat e të cilëve u validuan duke i krahasuar me studimet nga rastet e tjera të ngjashme. Sistemimi dhe analiza e të dhënave përmes kuadrit konceptual të zhvilluar për këtë studim udhëhoqi drejt konkluzioneve dhe rekomandimeve specifike.

Eksperti hasi një pjesëmarrje të ulët të OSHC-ve mjedisore dhe qytetarëve në plotësimin e pyetësorit në internet. Vetëm 15 plotësime u grumbulluan *on-line* dhe 27 pyetësorë të plotësuar në formë të printuar nga 40 të tillë të shpërndarë gjatë trajnimeve. Nga 42 pyetësorë në total (*on-line* dhe të printuar) u arrit në identifikimin e 25 konflikteve me bazë ujore. Pas punës dhe verifikimit në terren (2.2.4) eksperti arriti të finalizojë 18 raste konfliktuale të cilat janë të paraqitur në Shtojca si fletë informuese.

2.2.4 Puna në terren në komunitete e prekura nga konfliktet.

Ky aspekt i metodologjisë rrodhi natyrshëm nga metoda e rasteve studimore. Për të kuptuar panoramën e plotë të studimit të lënë si trashëgimi e ngjarjeve të konfliktit të identifikuar në seksionin 2.2.3 në vendndodhje të ndryshme në vend, kërkohej një hetim cilësor i thellë që kërkonte të ndriçonte mendimet e grupeve të aktorëve pas-konfliktit. Puna në terren i mundësoi ekspertit të kryente vëzhgime në vende specifike dhe në gjetjen e informuesve kryesore, ky rrëfenja dhe historitë personale dhe organizative i siguruan të dhënat e nevojshme nga ku mund të dilnin mësimet për të informuar dhe përpiluar rekomandime institucionale dhe adaptuese.

Për më tepër, puna në terren mundësoi përgatitjen e fletëve informuese individuale për secilin nga konfliktet e grumbulluar të cilat mund të gjinden si shtojca të këtij raporti.

2.2.5 Sistemimi, kontrolli i cilësisë, analiza dhe interpretimi i rezultateve dhe përpilimi i studimit.

Studimi i grumbullimit të informacionit të hapur publik, shqyrtimi i përgjithshëm i literaturës mbi konfliktet ujore u puq me studimin nga analiza e situatave të veçanta historike, gjeografike dhe

3. ANALIZA E REZULTATEVE



3

Hyrje

Ky seksion i raportit paraqet gjetjet e 42 pyetësorëve të grumbulluar nga të intervistuarit dhe vëzhgimet gjatë punës në terren të ekspertit në kuadër të projektit. Pyetësi u ndërmor nga eksperti me pikësynimin për të identifikuar rastet e kontestuara në lidhje me zhvillimin e hidroenergjisë në vend dhe shkaqet që qëndrojnë prapa këtyre kundërshtive.

Pyetësi i plotësuar on-line dhe direkt gjatë intervistave u realizua gjatë periudhës 18 qershor - 30 shtator dhe nga 2 deri në 28 dhjetor 2016. Në total u intervistuan 42 persona nga organizatat mjedisore dhe individë. Nga ky kampion, 16 të intervistuar ishin nga organizatat e shoqërisë civile, 18 qytetarë, 5 kërkues/ekspertë dhe 3 përfaqësues të bizneseve.

3.1 Shkaku i konflikteve


Ky seksion i studimit “shkaku i konfliktit” u

përqendrua në burimin e konflikteve ujore, komunitete e prekura, mbështetësit kryesorë dhe dinamikën e konfliktit.

Në figurën 3, të intervistuarit u pyetën të identifikonin nxitësit kryesorë të konfliktit dhe të **drejtat e ujit** janë shkaqet kryesore për konfliktet ujore lidhur me hidrocentralet në 36% të rasteve. Gjatë vizitave në terren dhe punës hulumtuese realizuar nga eksperti, **ndarja e ujit**, e lidhur me vaditjen dhe nevojat për bujqësinë qëndronte në krye të arsyeve për kontestimet e hidrocentraleve në vendet përkatëse. Shkatërrimi i mjedisit dhe mungesa e informimit dhe konsultimit janë gjithashtu ndër shkaqet kryesore me 29% dhe 21% të përgjigjeve.

Në pyetjen vijuese në Figurën 4 për përcaktimin e aktorëve, interesave dhe pozicioneve të tyre në konflikt, pothuajse gjysma e të intervistuarve 52%, u shprehën së komunitetet rurale janë ata që vuajnë më shumë pasojat. Zhvillimi i turizmit vendor u përcaktua si një ndër grupet e aktorëve

Figura 3:
Shkaku i konfliktit



më të prekur për shkak të zhvillimit të hidrocentraleve të cilat zinin rreth 24% të përgjigjeve.

Organizatave vendore janë mbështetësit kryesorë për komunitete rurale në konflikt në 33% të rasteve sipas përcaktimit të intervistuarve. Kjo

te mbështetësit e projekteve të kontestuara. Rreth 19% të rasteve janë ngritur nga komunitetet vendore siç është rasti i bashkisë Klos, e pozicionuar kundra zhvillimit të HEC-it Mat 1, që do të ketë një kanal dhe tunel devijues prej 8-9 km i cili “do të thante shtratin e lumit në bashkinë




Figura 4:
Njerëzit e prekur

mund të lidhet me afërsinë e organizatave lokale me qendrat e gjenerimit të konfliktit siç kanë qenë fshati Polis në zonën e Librazhdit apo në fshatin Bënçë të Tepelenës dhe në Dragobi të Tropojës.

Megjithatë, grupet komunitare dhe shkencëtarët zënë një pjesë të konsiderueshme

“Klos”, siç u shpreh kryetari i Bashkisë Klos. (Shiko fletën informuese nr. 5). Një grup tjetër mbështetës janë dhe shkencëtarët/profesorët/studuesit të cilët kanë marrë një pozicion të rëndësishëm në diskutimet kundra zhvillimit të shumë hidrocentraleve përmes artikujve dhe opinioneve të ndryshme.




Figura 5:
Mbështetësit kryesorë në konflikt

3.2 Gjeografia e konfliktit

Ky seksion i studimit, “gjeografia e konfliktit” fokusohet në mënyrë të detajuar tek vendndodhja e rasteve konfliktuale, origjina e zhvilluesve që ndërtojnë hidrocentralet, popullsia e përfshirë dhe kohëzgjatja e projektit.

Figura 6, tregon shpërndarjen e konflikteve përgjatë gjithë vendit e cila është në simetri me shpërndarjen e licencave të hidrocentraleve. Pavarësisht faktit se konflikti ka lindur në zonat rurale atje ku janë cënuar të drejtat e ujit, konflikti është manifestuar në zonat urbane ku ndodhen dhe institucionet. Shpeshherë, Tirana ka qenë epiqendra e protestave të shumta kundra HEC-eve nga grupet civile dhe qytetarët.

Ndërsa në lidhje me origjinën e kompanive të cilat janë të përfshira në konflikt, shumica e të intervistuarve nuk kishin informacion rreth tyre. Megjithatë, komunitetet rurale e lidhnin pronësinë e hidrocentraleve me emrat e politikanëve të lartë, zyrtarëve publikë të cilat ishin parë në vendngjarje gjatë protestës.¹⁰

Nga puna gjatë fazës hulumtuese në lidhje me pronësinë e hidrocentraleve, eksperti vërejtí se nuk ka kompani “të mira apo të këqija” bazuar në origjinën e tyre. Në të gjitha rastet e konflikteve, zhvilluesit janë nga Italia, Austria, Turqia dhe kompanitë vendase shqiptare. I vetmi ndryshim, qëndron në madhësinë e konfliktit. Në rastet kur në konflikt janë të përfshira kompanitë shqiptare, ato përpiqen ta zgjidhin përmes forcës,




Figure 6: Harta e konflikteve të hidrocentraleve. (Burimi: përgatitur nga autori, 2016)

me kërcënim, përçarjet në komunitet dhe korruptim të individëve me influencë në komunitet.¹¹

Përgjithësisht, kompanitë kanë shmangur praktikat e mira të të bërit biznes dhe në shumë raste kodet e tyre të korporatës nuk janë ndjekur megjithëse investimi është siguruar nga hua dhe kredi të bankave të ndryshme ndërkombëtare siç janë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, IFC, Banka Austriake për Zhvillim, KfW dhe Fondi për Rritje të Gjellbër.¹²

3.3 Mobilizimi i konfliktit

Në kategorinë e “mobilizimit të konfliktit”, do të analizohet lidhja e shkaqeve të konfliktit për sa i përket kohës, grupeve dhe formës së mobilizimit.

Eksperti përcaktoi 3 pyetje kryesore në këtë kategori me qëllim për të kuptuar fillimin e mobilizimit, grupet e aktorëve të cilët u mobilizuan në konflikt dhe kush ishte forma e reagimit.

Ndërsa, në lidhje me pyetjen për fillimin e mobilizimit në Figurën 7, të intervistuarit përgjithësisht u përgjigjën në 67% të rasteve se mobilizimi nisi si reagim i fillimit të projektit kur makineritë filluan të gërmonin në vend.

Megjithatë, në 10% të rasteve të intervistuarit janë përgjigjur se reagimi ka qenë rezistencë parandaluese kur kanë mësuar për herë të parë për planifikimin e projektit. Këto ishin rastet e hidrocentralit në Luginën e Valbonës, hidrocentralet në Lumin Mat dhe hidrocentrali i Poçem-it.




Figura 7:
Fillimi
i mobilizimit

¹⁰ Gjatë punës në terren eksperti u takua me fermerë nga Polisi, Gurshpata, Bënça, Nivica, Gusmari, Vinjoll, Bulqiza dhe Valikardha të cilët përmendën politikanë të ndryshëm dhe deputetë të lidhur me pronësinë e hidrocentraleve. Eksperti u përpoq të analizonte dhe kontrollonte pretendimet e ngritura për hidrocentralet përkatëse pranë QKR, por nuk gjeti asnjë përçarjes së komunitetit ose në rastin më të keq konflikte të brendshme në komunitet si janë rastet në fshatin Vinjoll, rrethi i Kurbinut.

¹¹ Banorët vendas kanë raportuar shumë raste ku njerëzit e kompanive koncesionare janë përfshirë në afera korruptive duke paguar kryepleqtë apo individë më influencë në komunitet për të zbutur dhe pushuar konfliktin. Kjo ka çuar drejt përçarjes së komunitetit ose në rastin më të keq konflikte të brendshme në komunitet si janë rastet në fshatin Vinjoll, rrethi i Kurbinut.

¹² Sikorova, K., Gallop, P., (2015), “Financimi i Hidrocentraleve në zonat e mbrojtura në Ejl”, CEE Bankwatch Network, përgatitur për Euro Natur dhe River Watch, dhjetor 2015.

Fatkeqësisht, pothuajse gjithë rastet e mobilizimit kanë ndodhur pas aprovimit të projektit të hidrocentralit dhe vetëm në një rast mobilizimi nisi si masë parandaluese kundrejt autoritetit planifikues para dhënies së koncesionit (HEC Poçem).

Grupet e aktorëve të cilët u mobilizuan (P # 4) gjatë rasteve konfliktuale të hidrocentraleve janë organizatat vendore, shkencëtarët, grupet komunitare, fermerët, media dhe qeverisja lokale. Siç tregohet në Figurën 8, organizatat vendore janë grupi kryesor i cili është angazhuar në mobilizimin e konfliktit në 31% të rasteve. Arsyeja mund të lidhet me afërsinë e qendrës së lindjes së konfliktit dhe lidhja e ngushtë me grupet komunitare. Nga ana tjetër kjo mund të argumentohet si kundër fakt nëse mobilizimi ka

drejtpërsëdrejti për shkak të mungesës së ujit për vaditje ose frikës ndaj humbjes së tij, kanë zënë 17% të rasteve. Rastet e fshatit Polis, Gurshpatë, Vinjoll, Valikardhë dhe Gojan janë drejtpërsëdrejti të lidhur me të drejtat e ndarjes së ujit siç janë përshkruar në seksionin më sipër. Megjithatë, një rol pozitiv kanë luajtur dhe komuniteti i shkencëtarëve (profesorë, kërkues) të cilët janë identifikuar si mobilizuesit kryesorë në 21% të rasteve. Duhet theksuar se organizatat ndërkombëtare siç janë River Watch, Euro natur, World Wild Fund dhe Bank Watch kanë luajtur një rol të konsiderueshëm në mobilizimin e fushatave të shumta kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ndërsa në lidhje me formën e mobilizimit, ashtu si tregohet në Figurën 9, protesta në rrugë ka qenë manifestimi kryesor i mobilizimit duke




Figura 8:
Grupet e mobilizuara

qenë i nxitur nga organizatat lokale apo nga njerëzit e prekur dhe nevoja e tyre reale.

Në 14% të rasteve, grupet komunitare kanë qenë të parët që janë mobilizuar direkt në rastet e konfliktit. Ndërsa fermerët të cilët janë të prekur

zënë rreth 35% të përgjigjeve. Arsyeja është ngushtësisht e lidhur me argumentin e shpjeguar në P#13 lidhur me kohën e informimit dhe reagimit pasi projekti kishte filluar punimet. Për më tepër, përfshirja e organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare ka qenë një formë e rëndësishme




Figura 9:
Forma
e mobilizimit
të komunitetit

e mobilizimit me 13% e ndjekur nga fushata publike me 10% të rasteve.

Për fat të keq, procedimet gjyqësore dhe paditë janë shumë të pakta si një mënyrë legjitime e formës së mobilizimit me vetëm 2-3% të rasteve. Arsyja mund të lidhet me mungesën e besimit në procesin gjyqësor dhe në të njëjtën kohë mungesën e njohurisë dhe eksperiencës me procesin gjyqësor.¹³ Megjithatë, të intervistuarit e kanë konsideruar peticionin dhe kundërshtimin e VNM-së si një instrument me influencë të cilat zënë 8% dhe 5% të rasteve.

3.4 Ndikimi i konfliktit

Në kategorinë e “ndikimit të konfliktit” eksperti zhvilloi 3 fusha kryesore për të kontrolluar ndikimin mjedisor të rasteve konfliktuale, pasojat shëndetësore dhe ndikimin socio-ekonomik. Të

intervistuarit kishin mundësinë e zgjedhjes të 3 alternativave të hartuara në lidhje me ndikimin e konfliktit: të dokumentuara ose vëzhguara, potenciale ose të pasigurta dhe opsioni s’kam informacion.

Në pyetjen (P#16) lidhur me ndikimin mjedisor, të intervistuarit identifikuan në 19% të rasteve si “*ndikim i dokumentuar*” shkatërrimin e peizazhit, e ndjekur nga humbja e biodiversitetit me 15% dhe shpyllëzimi dhe pakësimi i lidhjes hidrologjike/ekologjike me 12% të rasteve. Ndërsa në lidhje me ndikimin *potencial* ose të *pasigurt*, të intervistuarit përzgjedhën ndotjen e ujërave sipërfaqësore me 15%, pasigurinë ushqimore me 11%, përmbytjet me 12% dhe humbjen e biodiversitetit me 12%. Gjithashtu, të intervistuarit përzgjedhën opsionin *s’kam informacion* në shumë prej ndikimeve mjedisore lidhur me hidrocentralet konfliktuale. Të intervistuarit nuk u ndjenë shumë të sigurtë me

¹³ Gjatë organizimit të 3 trajnimeve në kuadër të projektit HELP-CSO, pjesëmarrësit treguan mungesë njohurie në procedimet ligjore siç është shprehur dhe nga studimi i analizës së aftësive përgatitur në kuadër të projektit HELP-CSO nga B.Beja.




Figure 10: Ndikimi mjedisor i konfliktit.

përcaktimin e ndikimit mjedisor të konfliktit përpos alternativës të peizazhit, atij estetik dhe shpyllëzimit.

Ndërsa në lidhje me ndikimin shëndetësor të konfliktit, të intervistuarit u pyetën rreth aksidenteve, problemeve të stresit dhe atyre psikologjike, sëmundjeve profesionale dhe aksidenteve ose problemeve të tjera mjedisore

(Figura 11). Vetëm 12 përgjigje u regjistruan si raste të dokumentuara, dhe 6 raste të tjera si probleme mjedisore të paspecifikuara. Shumica e të intervistuarve nuk kishin informacion rreth ndikimit shëndetësor si rezultat i konfliktit të hidrocentraleve. Përveçse 2 aksidenteve në punë në HEC-in Gojan dhe HEC Gjegjan (shiko shtojcën) pjesa tjetër e rasteve me ndikim shëndetësor është e lidhur me arrestimin e banorëve për shkak




Figure 11: Ndikimi shëndetësor

të protestave në rrugë kryesisht në fshatin Polis, Vinjoll, Valikardhë, Cërnalevë. Sërish, të intervistuarit nuk kanë të dhëna se kush mund të ishte ndikimi shëndetësor lidhur me hidrocentralet.


Për sa i përket pyetjes rreth ndikimit socio-ekonomik (P#18) më shumë se gjysma e të intervistuarve 54%, kanë identifikuar si të dokumentuar ose vëzhguar ndikimin në bujqësi dhe ujin vaditës. Njëkohësisht ndikimi tjetër që është i dokumentuar paraqitet zhvillimi turistik me 21% të përgjigjeve, që dëshmon lidhjen e fortë ekonomike me potencialin turistik. Një element tjetër me interes është rritja e korrupsionit i cili vlerësohet me 15% të rasteve dhe është i barabartë me humbjen e peizazhit dhe përkatësisë së vendit.

Autori arriti të identifikojë se në 3 prej rasteve të hidrocentraleve konfliktuale, kryepërgjegjësit ishin të punësuar si roje nga kompanitë koncesionare (Vinjoll, Gurshpatë dhe Bënçë). Në 10% të rasteve, të intervistuarit përzgjedhën zhvendosjen si një ndikim socio-ekonomik. Kjo është ngushtësisht e

lidhur si një rrjedhojë e ndikimit bujqësor nëse uji vaditës do të mungojë. Më 16 dhjetor, banorët e Bashkisë Klos e shndërruan një sesion informimi nga kompania *Mat Hydropower*, në një protestë të gjerë komunitare duke argumentuar se ndërtimi i hidrocentralit do ti linte pa ujë, do të shkaktonte një zhvendosje të detyrueshme dhe masive të banorëve. Në të vërtetë eksperti e hasi të njëjtën frikë zhvendosjeje në shumë prej zonave të hidrocentraleve të cilat ishin ndërtuar pa licencën sociale të komunitetit.

Ndikimi i konfliktit është i perceptuar dhe manifestuar në mënyrë të ndryshme nga grupe të ndryshme aktorësh. Ndikimi mjedisor i zhvillimit të hidrocentraleve në zonat e ndjeshme mjedisore është më shumë i bazuar në gjykim ekspertësh si një fushë për organizatat lokale dhe shkencëtarët. Ndërsa për komunitet vendore, fermerët dhe peshkatarët e lidhin direkt me ndikimin ekonomik për vaditjen, bujqësinë dhe ndjenjën e përkatësisë së vendit si përdorues tradicionalë të ujit.

Figura 12:
Ndikimi socio-ekonomik i hidrocentraleve konfliktuale






Figura 13:
Statusi aktual i projektit

3.5 Rezultati i konfliktit

Në kategorinë e “rezultatit të konfliktit”, autori hartoi pesë pyetje (P#19-23) me qëllim të kuptonte statusin e projektit, rezultatit e konfliktit dhe nëse konflikti ka qenë një rast i suksesshëm.

Në lidhje me pyetjen e statusit Figura 13, të intervistuarit përzgjedhën në 48% të rasteve se projekti ishte në operim/prodhim energjie. Kjo ndiqej nga 24% e rasteve në ndërtim dhe 19% në fazë planifikuese duke pritur marrjen e licencave përkatëse.

Fatkeqësisht, vetëm 2%, që korrespondon me 2 raste konflikti në Bënçë dhe Kalivaç projekti u ndal. Megjithatë nga vëzhgimet e ekspertit në terren banorët dëshmuuan se arsyeja e vërtetë e pezullimit ishte mungesa e fondeve nga kompania

sesa rezultat i kundërshtive të banorëve apo protestave të tyre.

Ndërsa në lidhje me rezultatit e konfliktit sipas Figurës 14, të intervistuarit u shprehën në 24% të rasteve se rezultati i konfliktit ishte forcimi i pjesëmarrjes publike për çështjen në fjalë. 12% e të intervistuarve u përgjigjën se rezultati ishin praktikatat korruptive të njerëzve dhe autoriteteve të përfshirë.

Megjithatë, 12% u përgjigjën se rezultati ishte negociata e alternativave. Në të vërtetë, nga takimet dhe verifikimet në terren ekspertit mundi të identifikojë se komunitetet vendore në Klos, Poçem dhe Bënçë kanë kërkuar alternativa të projektit gjatë protestave të tyre. Eksperti nuk gjeti raste pozitive të kompensimit që mund të merrej në konsideratë si rezultat i konfliktit.




Tabela 14:
Statusi i konfliktit

Të anketuarit u shprehën se 64% e rasteve konfliktuale kanë qenë të pasuksesshme. Megjithatë 33% mendojnë se nuk janë të sigurt për rezultatin e konfliktit. Ko shpjegohet me faktin se shumë prej këtyre rasteve janë në vazhdim dhe në fazën planifikuese e cila mund të kthehet si në rast pozitiv ose negativ. Fatkeqësisht, organizatat vendore dhe komunitete vendore konsiderojnë si sukses vetëm anulimin e projektit dhe gjithë energjia e tyre është e investuar në këtë drejtim. Dështimi apo zhgënjimi në arritjen e kësaj shpjegon dhe mungesën e interesit në përmirësimin e projektit, kërkesat për kompensim apo studime të mëtejshme për VNM-në.




Figura 15
Suksesi i drejtësisë mjedisore

4. DISKUTIMI I REZULTATEVE



4

Në shënimet udhëzuese për përdorimin e modelit EJOLT, autorët janë të ndërgjegjshëm se i gjithë koncepti është gjurmimi i të gjitha rasteve të drejtësisë mjedisore. Megjithatë informacioni dhe progresi i rasteve është i mbushur me vështirësi dhe mundësi për shtrembërime. Me këtë në mendje analizat e paraqitura në këtë seksion, fokusohen kryesisht në pesë elementët e EJOLT-it si shkak i konfliktit, gjeografia e konfliktit, mobilizimi i konfliktit, ndikimi i konfliktit dhe rezultati.

Nga ana tjetër siç është paraqitur dhe në seksionin 1.2 (*objekti dhe qëllimi i studimit*), ky dokument synon të ndihmojë në diskutimet e zhvillimit të qëndrueshëm të hidroenergjisë me një theks të veçantë në rastet e konflikteve ujore të lidhura me hidrocentralet. Me këtë qëllim, rezultati kryesor i këtij studimi është përgatitja e 18 fletëve informuese individuale për secilin nga rastet konfliktuale të hidrocentraleve të paraqitura në formën e shtojcave bashkëlidhur këtij raporti.

Megjithatë, është e rëndësishme të paraqesim disa vëzhgime para diskutimit në detaje të

rezultateve në seksionet në vijim.

Zhvillimi i hidrocentraleve me rëndësi ekonomike duke përfshirë dhe ata me digë nuk mund të shikohen dhe kuptohen vetëm si projekte për përmbushjen e sigurisë energjetike të vendit dhe përfitimeve ekonomike. Ndërtimi i këtyre projekteve vendos në lëvizje forca që theksojnë tensionet dhe kontradiktat mes vlerave dhe interesave sociale, ekonomike, ekologjike dhe kulturore të cilat më vete reflektojnë konflikte potenciale. Përgjithësisht, 34 persona u arrestuan, shoqëruar ose u lëshua urdhër ndalimi dhe 6 viktima u raportuan gjatë punës në terren.¹⁴ Mes të arrestuarve 6 ishin gra dhe 1 i mitur.

Adresimi i konflikteve ujore dhe mjedisore sjell që grupe të ndryshme sociale dhe komunitete përballen me nivele të ndryshme vështirësie në aksesin, kontrollin ose ruajtjen e vlerave të tyre kulturore të lidhura me ujin. Në gjithë rastet konfliktuale të analizuara, grupet më të cënuara ishin komunitete rurale, fshatrat e vegjël dhe komunitetet jeta e të cilëve ishte e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me burimet ujore për ushqimin e tyre. Transformimi dhe tjetërsimi i territorit dhe ekosistemit të tyre nga përdorues të rinj (kompanitë koncesionare energjetike) i

¹⁴ Statistikat e mbledhura nga autori bazuar në komunikatat për shtyp të Policisë së Shtetit në 2 prill 2016; 25 maj 2016; 17 nëntor 2014; <https://www.asp.gov.al/arkiva>

zhvendoste të drejtat e tyre tradicionale dhe kërcënon aspekte të ndryshme të strukturës dhe kohezionit social të tyre.

Shkaqet e konfliktit

“Shkaqet” janë elementi i parë në kuadrin e modelit EJOLT që prezanton kontekstin dhe rrënjët në të cilat ka lindur konflikti. Në pyetësor ky element u prezantua me pyetje. Në përgjigjet e tyre të intervistuarit përzgjedhën të drejtat e ujit si shkakun kryesor të konfliktit në 36% të rasteve dhe 52% të aktorëve të prekur ishin fermerët dhe komunitetet. Mbështetësit kryesorë në konflikt ishin organizatat vendore me 33% të rasteve të ndjekur nga komunitete vendore dhe shkencëtarët. Megjithatë, eksperti vërejti se angazhimi dhe investimi politik ishte një mbështetës kryesor në 3 prej rasteve të konflikteve.² Eksperti vërejti njëkohësisht se në konfliktet e identifikuar, së shumti reflektojnë humbjen e kontrollit ose të drejtën e aksesit dhe përdorimit të burimeve ujore kur ekziston perceptimi nga komuniteti i ekspozimit për ndryshimin e sistemit të tyre të prodhimit (produkteve bujqësore, ushqim për bagëtinë, përkatësia e vendit).

Gjeografia e konfliktit

“Gjeografia” ishte elementi i dytë i cili kishte shumicën e pyetjeve me qëllim identifikimin e aktorëve të përfshirë, fillimin dhe mbarimin e konfliktit, kompanitë dhe investitorët e përfshirë. Fatkeqësisht, elementi i gjeografisë ishte pjesa që së shumti ishte pa përgjigje për shkak të mungesës së informacionit nga të intervistuarit duke përfshirë këtu dhe organizatat vendore, qytetarët dhe autoritet vendore. Asnjë kompani, nuk bëri përjashtim bazuar në origjinë pasi të gjitha janë të përfshira në konflikt siç janë ato turke, austriake, italiane dhe shqiptare. Megjithatë eksperti vërejti se madhësia e konfliktit kur ishin përfshirë kompanitë shqiptare ishte më e ashpër, duke krijuar praktika korruptive përmes bakshisheve me anëtarë të veçantë të komunitetit të cilët kanë krijuar premisa për konflikte të ardhshme.

Mobilizimi i konfliktit

“Mobilizimi” është elementi i tretë i përfaqësuar me tri pyetje kryesore me interes për kohën, grupet dhe formën e mobilizimit. Në 67% të rasteve të anketuarit u shprehën se konflikti

nisi si një reagim i fillimit të projektit. Statistikat shpjegojnë një korrelacion të fortë me formën e reagimit që është së shumti e manifestuar me protestën në rrugë në 35% të rasteve. Aktorët rrallë herë e konsiderojnë procedimin gjyqësor si formën më produktive të mobilizimit. Në kohën e studimit, ekziston vetëm një rast i paraqitur në gjykatë nga Eko Albania dhe banorët e zonës në lidhje me HEC-in e Poçem-it. Megjithatë, eksperti ka vërejtur se grupet lokale mjedisore e kanë rritur mobilizimin e tyre lidhur me kundërshtimin e VNM-ve, kërkesave dhe ankesave administrative. Por, komunitetet vendore, banorët dhe fshatarët nuk i konsiderojnë këto forma si të përshtatshme. Gjatë një takimi me banorë të fshatit Polis, Librazhd në 3 dhjetor 2016, Beqir Shato u shpreh se: *“I kemi provuar të gjitha format e peticioneve dhe kërkesave me kryeplakun, kryetarin e bashkisë dhe deputetin e zonës...por asnjëra nuk u dëgjua prandaj protestuam si rrugë të vetme”*.

Ndikimi i konfliktit

“Ndikimi” është elementi i katërt i modelit të vlerësimit EJOLT që konsiston në tri pyetje kryesore për matjen e ndikimit mjedisor, shëndetësor dhe socio-ekonomik në konflikt. Të intervistuarit identifikuan në 19% të rasteve si ndikim i dokumentuar në rastet konfliktuale humbjen e peizazhit e ndjekur nga humbja e biodiversitetit me 15% dhe më pas shpyllëzimin dhe pakësimin e lidhjes ekologjike/hidrologjike në 12% të rasteve. Ndërsa në lidhje me ndikimin potencial ose të pasigurt, të anketuarit zgjedhën ndotjen e ujit sipërfaqësor me 15% të rasteve, pasigurinë ushqimore me 11%, përmbytjet me 12% dhe humbjen e biodiversitetit me 12%. Të intervistuarit nuk u ndjenë shumë të sigurtë në identifikimin e ndikimit shëndetësor të konfliktit. Në lidhje me ndikimin ekonomik 54% e rasteve zgjedhën bujqësinë dhe ujin për vaditje të ndjekur nga ndikimi në turizëm me 15%. Humbja e përkatësisë së vendit dhe korrupsioni u vlerësuan si ndikime potenciale në konfliktet e hidrocentraleve. Mungesa e studimeve të sakta dhe fushatave informuese për organizatat vendore, qytetarët dhe fermerët dhe vendim-marrësit vendorë mbi ndikimin mjedisor të hidrocentraleve qëndron si një ndër justifikimet kryesore për këtë vlerësim. Eksperti e vërejti këtë boshllëk gjatë bisedave me shoqatat mjedisore, autoritetet lokale dhe qytetarët gjatë vizitave në terren. Për më tepër, fakti ku shumë prej rasteve konfliktuale kanë pushuar pas ndërtimit të hidrocentraleve dhe operimit të tyre dëshmon, se nuk ka pat një monitorim real

dhe vazhdimësi për performancën e hidrocentralit mbi përdorimin e ujit dhe respektimin e kontratave.

Rezultati i konfliktit

“Rezultati” është elementi i pestë i modelit të vlerësimit EJOLT i cili përbëhet nga pesë pyetje kryesore kryesisht në analizimin e statusit të projektit, rezultati i konfliktit dhe nëse konflikti rezultoi i suksesshëm ose jo. 64% e të intervistuarve u shprehën se konflikti nuk ishte i suksesshëm dhe rezultati kryesisht ishte i kufizuar në rritjen e forcimit të pjesëmarrjes e vlerësuar me 24% të rasteve. Megjithatë, eksperti vërejti se përkufizimi i suksesit ishte së shumti i lidhur me “ndërtimin” ose “ ndalimin” e hidrocentralit ku 48% e rasteve konfliktuale lidheshin me hidrocentralet në operim dhe 24% me hidrocentralet në ndërtimin dhe vetëm 2 projekte ishin të ndalur, për shkaqe të mungesës së burimeve financiare. Eksperti është i mendimit se grupet e aktorëve duhet ta përkufizojnë saktë termin rezultat i konfliktit me qëllim maksimizimin e përfitimeve jo vetëm të kufizuara me ndërtimin fizik ose jo të projektit por dhe me performancën e tij gjatë operimit dhe monitorimit të vazhdueshëm në lidhje me ndarjen e ujit.

5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME



5

Ky studim vlerësues arriti të identifikojë 18 konflikte ujore të lidhura me hidrocentralet në Shqipëri. Gjithashtu, u përgatitën 18 fletë informuese duke paraqitur për herë të parë një studim i cili do të përkthehet në një hartë konfliktesh ndër aktive për aksesin e publikut, kërkuesve, autoriteteve vendore dhe publikun e gjerë.

Ndarja e ujit dhe uji për vaditje janë etiketuar si kërcënimet/shkaqet më serioze në lidhje me konfliktet ujore të lidhura me hidrocentralet në Shqipëri. Mungesa e informacionit dhe konsultimit publik janë njohur si një shkak i përbashkët në 21% të rasteve të konfliktit të ndjekura nga humbja e peizazhit dhe përkatësisë së vendit. 52% e të intervistuarve janë shprehur se komunitetet vendore, fermerët dhe fshatarët janë grupi i aktorëve nga më të prekurit për shkak të konflikteve me hidrocentralet. Ndërsa ndikimi i konfliktit është manifestuar në mënyra të ndryshme nga grupet e afektuar ku shoqatat mjedisore janë të fokusuar në humbjen e peizazhit, biodiversitetit dhe përmbytjeve ndërsa fshatarët dhe komunitetet të fokusuar në mungesën e ujit vaditës dhe shkatërrimin e bujqësisë në 54% të rasteve. Grupet e prekura nga konflikti nuk janë shumë optimistë me rezultatin e konfliktit ku 64% e të intervistuarve janë shprehur se rastet nuk kanë qenë të suksesshme, megjithatë kanë pranuar faktin se ka një përmirësim në forcimin e informimit dhe pjesëmarrjes publik si rezultat i përfshirjes në konflikt me hidrocentralet.

Fatkeqësisht, eksperti nuk mundi të identifikojë ndonjë rast ose të gjente një dokument ku palët kanë arritur një marrëveshje formale rreth kompensimit ose dakordësisë në rastet e kontestuara. Megjithatë gjatë vizitave në terren është përmendur në dy raste (Vinjoll dhe Polis) për një marrëveshje joformale për ndarjen e ujit për vaditje gjatë verës pas organizimit të një sërë protestash civile.

Aktorët vendore kanë referuar një fenomen të ri, e dëshmuar dhe nga eksperti gjatë vizitave në terren i të ashtuquajturit “kolonializmi i tokës”. Kompanitë koncesionare, pa asnjë dokument ose leje përkatëse kanë uzurpuar një hapësirë të madhe territori dhe toke përreth komponentëve të hidrocentralit si centrali, vepra e marrjes dhe tubacioneve. Kjo ishte bërë përmes rrethimit me

gardh të territorit dhe e ruajtur me polici private duke mos lejuar aksesin e banorëve. Ky fat tregon qartazi pasojat e konflikteve të pazgjidhura në shumë projekte që duhen adresuar në mënyrë të menjëhershme.

Një aspekt tjetër me interes i hasur nga eksperti ishte kërcënimi dhe metoda “përça e sundo” e përdorur nga kompanitë koncesionare përmes kryepleqve (kryetarëve të fshatit). Në shumë raste, kryeplaku ishte i punësuar nga kompania si roje sigurie në hidrocentral duke shkaktuar pakënaqësi brenda komunitetit dhe përçarje mes tyre. Kjo metodë thjesht shtynte konfliktin në kohë por nuk e zgjidhte atë,(Gurshpatë, Vinjoll).

Gjatë vizitave në terren u propozua dhe një ide novatore nga ana e autoriteteve vendore për pakësimin e situatave konfliktuale lidhur me hidrocentralet e vegjël ku vet bashkia mund të bëhej zhvilluesi i hidrocentralit dhe ti përkthente të ardhurat prej tij në investime publike për komunitetin. Modeli i biznesit që u përmend ishte i njëjti i përdorur nga Kisha Autoqefale Ortodokse e Shqipërisë në rastin e ndërtimit të HEC-it Rrapun3&4 si një shembull që mund të transferohej. Megjithatë duhet shënuar se nuk është forma e biznesit por mënyra e të bërit biznes që përcakton nëse një projekt është i suksesshëm ose jo.¹⁵

Aktorët e prekur, organizatat vendore, grupet e shkencëtarëve duhet të marrin në konsideratë masat parandaluese kundrejt autoritetit planifikues përmes mobilizimit të tyre përpara lëshimit të koncesionit nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë. Kjo do t’iu mundësonte më shumë avantazh për procesin planifikues, të kontrollonin planet dhe projektet dhe të përfitonin kohë të mjaftueshme për paraqitjen e alternativave dhe përmirësimit të projektit.

Së fundmi, të gjithë aktorët, kompanitë energjetike, organizatat vendore dhe grupet komunitare duhet ta marrin në konsideratë realisht zhvendosjen e strategjisë së tyre për rezultat të konfliktit të hidrocentraleve duke kaluar nga situata tradicionale “fito-humb” drejt “fito-fito”. Kjo do të mundësonte përmirësimin e projektit në fazën e ndërtimit, monitoronte ndarjen e ujit gjatë fazës së operimit dhe do të shmangte lindjen e konflikteve të ardhshme.

¹⁵ HEC Rrapun3&4 është pjesë e projekteve të kontestuara dhe i ranguar si shumë dobët nga OSHC për shkak të ndikimit mjedisor që ka sjellë.

REFERENCA

Barber, M., and Jackson, S. (2014). *Autonomia dhe ndërkulturorja: interpretimi i historisë Australiane të menaxhimit të ujit të Aborigjenëve në ujëmbledhësin e Lumit Roper*, Territori Verior. Periodiku i Institutit të Antropologjisë Mbretërore, 20, 670-693.

Qendro, E., M.S.c, Shumka, S., Prof, Leskoviku, A., Mazreku, V., Cela, E., & Buzi, B. (n.d.), 2015 – *Alternativa mjedisore e hidrocentraleve të vegjël në Shqipëri*, Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri, Tirana, shtator 2015.

Peña, F. (2004). *Pueblo's indígenas y manejo de recursos hídricos en México*. *Revista MAD*, 11, 20-29.
AlbEITI 2015, - "Raporti për Industrinë Nxjerrëse 2013 dhe 2014 në Shqipëri, fq.249-257

UNDP 2016, "Raporti Bazë i Basenit të Lumit Drin"

UNDP 2016, "Raporti Bazë i Basenit të Lumit Mat";

Zela G. (2015), *Raporti përfundimtar për identifikimin e ndikimeve nga ndërtimi i HEC-eve në Rrethin e Librazhdit*, Ekolevizja, maj-gusht 2015.

Sikorova, K., Gallop, P., (2015), "Financimi i hidrocentraleve në zonat e mbrojtura në EJL", Rrjeti Bankwatch për Euro Natur dhe River Watch.

SHTOJCA

1

2

3

4

#	Vendi i konfliktit	Emri i HEC	Emri i kompanisë	Numri i NIPT	Shkaku i konfliktit	Forma e mobilizimit
1	Valikardhë, Njësia Administrative Zerqan	HEC Tërnova	TEODOR 2003 SHPK Aksionarët: [Societe General Group & BERZH & Teodor Koka] 18.500.000 EUR	K42301006L	Përdorimi i ujit për vaditje (2,000 ha tokë); mungesa e vaditjes për shkak të mungesës së ujit. Uji merret nga Liqeni i Zi duke përdorur një sërë kanalesh nga liqeni drejt hidrocentralit.	Protestë dhe konflikt me zjarrin ndërtesës së hidr arrestuan dhe u përdor
2	Valbone, Tropoje	HEC Dragobia HPP Cerem	Dragobia Energy SHPK Shareholder: GENER 2 100% 175.5 Mill EUR	K92025004T	Shkatërrimi i peizazhit, ndikim në turizëm dhe humbja e biodiversitetit.	Peticion, letër ankese, rruge, kërkesa të shumt
3	Valbone, Tropoja	HEC T-Plan	T-PLAN shpk Pronar Flamur Bucpapaj	L09702601M	Shkatërrimi i peizazhit, ndikimi në turizëm dhe biodiversitetit.	Peticione, letër ankese, ndërkombëtare, protest qeverisë.
4	Cernaleve, Zapod	HEC Cernaleve	HIDRO ALBANIA ENERGY (Hydro Albania 27% +G.P.G.Company 66% + Instituti Dekliada 7 %)	K984202020	SHKATËRRIMI I PEIZAZHIT DHE TOKËS. MUNGESA E INFORMIMIT DHE NDAJES SË PËRFITIMEVE.	Protestë civile. 4 të arr moshën 15 vjeç.
5	Klos	HEC Mat 1, 2, 3	MATI HYDROPOWER Aksionarët: [Enso Hydro Energy 90% + Riviera (10%)]	L22212004A	Këshilli i Bashkisë kundërshtoi vendimin e KM për ndërtimin e HEC-eve mbi lumin Mat bazuar në mbi përdorimin e burimeve ujore	Protestë rruge, kërkes ndryshim projekti.
6	Krastë, Bulqizë	HEC Peshku	Koka & Ergi Energy Peshku” shpk 5.5 Milion EUR	K88027901B	Konflikt për furnizimin me ujë dhe ujin vaditës për fermerët vendas. Konflikt pronësie.	Konflikt për ndërtimin e pretendohet për porosi të tokës ku ndërtohet H
7	Qafë Mollë/Mirditë	HEC Fangu	AYEN AS Energji sha Aksionarët: (AYEN ENERJI ANONIM SIRKETI 82% + AyeI Elektrik Uretim Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi 8% + AS ENERGY + 1% Fahrettin Amir Arman) Investment: 100 Million EUR 110.54 MË	L11731504A	Shpërthimi dhe shkatërrimi i shtëpive. Humbja e burimeve ujore. Kushtet e punës. 3 persona të vdekur.	Konflikt me forcat e po vdekur.
8	Gojan,Pukë	HEC Gojan	AS Energy shpk Pronar S.L	L11731504A	Konflikt për të drejtën e përdorimit të ujit.	Roja i hidrocentralit n shpërthehet me tritol.
9	Vinjollë, Kurbin	HEC Hurdhas 1,2,3	KOMP ENERGI A: (Michael Morciniec 49% +	K82318002A	Pronësia e tokës ku kalon rruga e HEC-it.	Vrasja e 1 banori i lidh Protesta rruge dhe bllok

#	Vendi i konfliktit	Emri i HEC	Emri i kompanisë	Numri i NIPT	Shkaku i konfliktit	Forma e mobilizimit
9	Vinjollë, Kurbin	HEC Hurdhas 1,2,3	KOMP ENERGJI A: (Michael Morciniec 49% + Filip Lala 51%) STGC CORP inc	K82318002A	Pronësia e tokës ku kalon rruga e HEC-it.	Vrasja e 1 banori i lidhur me Protesta rruge dhe bllok
10	Polis, Librazhd	HEC Gurshpat 1 & 2	Gurshpate Energy Shpk K914250170 Aksionerët (51%) MAR ENERGY & ARJANA-C" SHPK	K914250170	Përdorimi i ujit, pakësimi i burimeve ujore për bujqësinë dhe konsumin lokal.	Protestë rruge, përplasj 8 personave (3 gra dhe
11	Librazhd	HEC Rrapun 1&2, 3&4	C& S Construction Energy shpk	K81914029T	Menaxhimi i ujit ekologjik, shkatërrimi i peizazhit, mungesa e konsultimit publik shkatërrimi i parkut kombëtar.	Dhuna, bojkot, protestë,
12	Togëz, Librazhd	HEC Rrapun 3&4	C&S Energy	K92402005Q	Menaxhimi i ujit ekologjik, shkatërrimi i peizazhit, mungesa e konsultimit publik shkatërrimi i parkut kombëtar.	Dhuna, bojkot, protestë,
13	Poçem, Mallakastër	HPP Poçem	"Cinar-San Tiran Branch" Ayen Enerji Şirketi Anonymous" dhe "Çinar-San Hafriyat Nakliyat Turizm Insaat San Ve Tic Ltd.Sti	L 22124014S	Pronësia e tokës, zona e përmytur, mungesë e konsultimit publik.	Protestë rruge, mbules ndërkombëtare, rishiki gjyqësor.
14	Lengarica/Përmet	HEC Lengarica	Lengarica & Energy Aksionerët: Hasi Energy & Enso Hydro Energy	K83026602A	Shkatërrimi i zonës së mbrojtur. Mungesa e konsultimit dhe shkatërrimi i ujërave termale.	Protestë rruge, mobiliz mediatike dhe mbështje gjyqësore.
15	Kalivaç Tepelenë	HEC Kalivac	EnergyShpk., HEC Kalivac, KALIVAC GREEN ENERGY SHPK	K72326018B	Mungesa e pagesave dhe respektimi i kontratës.	Protestë civile dhe konfi
16	Bënça, Tepelenë	HEC Bënça & Tepelenë	Bashkim i përkohshëm i shoqërive "Ferar" sh.p.k, "Alfa Projekt 2006" sh.p.k	K91915001Q	Ndikimi në eko-turizëm, shkatërrim i peizazhit, mungesë e pjesëmarrjes publike.	Fushatë mediatike, prot
17	Nivicë, Tepelenë	HEC Driza 1	Kendrevic Energy	L39610501A	Humbja e florës dhe faunës, kërcënim i turizmit, përkatësisë së vendit.	Artikuj, përplasje insti letër ankese.
18	Kacinar, Mirditë	HEC Lusa Lusen,1&2&3, 4	Shperdhaza-Energji SHPK Pronar KOMP ENERGJI" E "STGC CORP" Inc	L01829004H	Bllokim i rrugës për shkak të ndërtimit të HEC-it.	Protestë rruge

Shtojca 1:

Regjistri i konflikteve ujore lidhur me hidrocentralet

Burimi: Hulumtimi në zyrë dhe media

Shtojca 2:

Lista e aktorëve të konsultuar

Grupet e aktorëve	Emri i aktorëve (emri i institucionit ose individit)		Vendi dhe data e takimit
1. Komuniteti lokal	Fshati Polis	Beqir Shato	Polis, 2 dhjetor 2016
	Fshati Polis	Artan Shato	Polis, 2 dhjetor 2016
	Fshati Polis	Behar Bufi	Polis, 2 dhjetor 2016
	Fshati Gurshpatë	Haki Guberi	Gurshpatë, 2 dhjetor 2016
	Fshati Gurshpatë	Nexhmije Guberi	Gurshpatë, 2 dhjetor 2016
	Fshati Gusmar	Luan Gjoni	Gusmar, 17 dhjetor 2016
	Fshati Progonat	Dritan Qendro	Progonat, 18 dhjetor 2016
	Fshati Progonat	Florian Haska,	Progonat, 18 dhjetor 2016
	Fshati Bençë	Gezim Shehu	Bënçë, 17 dhjetor 2016
	Fshati Bençë	Laver Shehu	Bënçë, 17 dhjetor 2016
	Fshati Vinjoll	Islam Sinani	Laç, 27 dhjetor 2016
	Fshati Vinjol	Lad Neziri	Laç, 27 dhejtor 2016
	Fshati Gallate	Isuf Xhaferi	Laç, 27 dhejtor 2016
2. Institucione dhe agjenci shtetërore	Kryetari i Bashkisë Tepelenë	Mr. Termet Peci	Bashki, 17 dhjetor 2016
	Kryetari i Bashkisë Klos	Mr. Basir Cupa	Klos, 28 dhjetor 2016
	Agjencia Kombëtare për Burimet Natyrore	Mr. Artan Leskoviku	Tiranë, 22 nëntor 2016
	ADZM Kukës	Lefter Gjana	Kukës, shtator 2016
3. Kërkues dhe ekspertë	Kërkues për legjislacionin e energjisë	Dr. Lorenc Gordani	Tiranë, 18 nëntor 2016
	Ekspert VNMR	Klodian Aliu	Tiranë, 9 janar 2017
	Ekspert VNM dhe trainer	Scott Crosssett	Tiranë, 14 dhjetor 2016
4. Media lokale/gazetarë/OSHC	Shoqata Egnatia	Agjim Blloshmi	Librazhd, 2 dhjetor 2016
	Shoqata Egnatia	Ediola Terziu	Librazhd, 2 dhjetor 2016
	Shoqata SHERM	Danjel Bica	Bulqizë, 27 dhjetor 2016
	Eco Albania	Olsi Nika	Poçëm, 3 dhjetor 2016
	Lex Ferenda	Odeta Jahaj	Tiranë, 14 shtator 2016
	Mileukontakt Shqipëri	Rrezarta Ago	Tiranë, tetor 2016
	Milieukontakt Shqipëri	Valbona Mazreku	Tiranë, dhjetor 2016
	Pro Bono	Anteo Papa	Tiranë, 21 korrik 2016
	Agri En	Isuf Dervishi	Librazhd, 15 shtator 2016
	Qendra e Informacionit Vlorë	Robert Murataj	Tiranë, 9 dhjetor 2016
	Selenicë	Islam Islamaj	Selenicë, 17 janar 2017
	Selenicë	Mitat Brahimi	Selenicë, 17 janar 2017.
5. Komuniteti i biznesit/Zhvilluesi	Gusmar Energy sh.p.k	Siro Sinani, Administrator	Gusmar, 17 dhjetor 2016
	Investitor privat	Daut Gjokola Administrator	Tokëz, 2 dhjetor 2016
	Investitor privat	Hazis Lika	Laç, 27 dhjetor 2016



HEC Bença -Lugina e Bençës, 17 dhjetor 2016;
Foto e realizuar nga E. Qendro



HEC Bença - 17dhjetor 2016;
© Andrew Blurr



Protesta kundër ndërtimit të HEC-eve në Lumin Vjosë;
© Andrew Burr, 2016



Protestë kundër ndërtimit të HEC-eve në Lumin Valbonë.
Foto e realizuar nga Eco Albania.



HEC Tervoli
Foto e realizuar nga D. Bica; 2013



HEC Tervoli - Bulqizë, 2013;
Realizuar nga Teodor 2003 shpk



HEC Rrapun 2
Foto e realizuar nga A. Biloshmi; 3 dhjetor 2016



HEC Gojan - Foto realizuar nga C. Volmer; 28 maj 2016



Shtrati i lumit në Rrapun, 3dhjetor 2016;
Foto realizuar nga E.Qendro

Shtojca 4:

Fletë informuese për konfliktet ujore të lidhura me hidrocentralet

- Fletë informuese 1: Kundërshtimi i komunitetit për hidrocentralin e financuar nga BERZH në Tërnovë.
- Fletë informuese 2: Lufta për Zembrën Blu të Alpeve shqiptare. Lugina e Valbonës.
- Fletë informuese 3: HEC Valbona (Tplani) devijon projektin teknik dhe përballet me protesta.
- Fletë informuese 4: HEC Cërnaleva than mulli-të e ujit dhe thëllon varfërinë e banorëve të Cernalevës.
- Fletë informuese 5: HEC Mati 1, 2, 3 - Banorët kundra hidrocentralit; kërcënon bujqësinë.
- Fletë informuese 6: HEC Peshku konflikt mbi pronësinë me banorët lokalë.
- Fletë informuese 7: HEC Fani përballet me përplasje nga komuniteti dhe protesta për tjetërsimin e tokës.
- Fletë informuese 8: HEC Vinjoll: Konflikti për përdorimin e ujit përshkallëzohet në viktima.
- Fletë informuese 9: HEC Gurshpatë kryeson listën e protestave për shkak të të drejtave të ndarjes së ujit.
- Fletë informuese 10: HEC Rrapun 1&2: Uzurpim i tokës dhe erozion i lartë.
- Fletë informuese 11: HEC Rrapun 3, 3A&4: Zhvillim i kaskadës: Uji humbet në tuba çeliku.
- Fletë informuese 12: HEC Kalivaçi një konflikt i tejzgatur; Dëshmi e një sistemit të dështuar qeverisës.
- Fletë informuese 13: HEC Poçem shkon në gjykatë.
- Fletë informuese 14: HEC Lengarica rrezikon monumentin e natyrës Kanioni i Lengaricës dhe parkun kombëtar.
- Fletë informuese 15: HEC Bënça & Tepelena: trashëgimia kulturore dhe mjedisore e kërcënuar.
- Fletë informuese 16: Kanionet e Nivicës dhe potenciali turistik i kërcënuar nga zhvillimi i paplanifikuar.

Fletë informuese 1:

Kundërshtimi i komunitetit për hidrocentralin e financuar nga BERZH-i në Tërnovë

Përshkrimi	<p>Në vitin 2012 BERZH-i miratoi një financim prej 6 milion EUR për ndërtimin e hidrocentralit të Tërnovës prej 8.3 MW. Skema e projektit, devijon rrjedhën e ujit nga katër liqene malore që kanë shërbyer për qëllime vaditje dhe si burim për ujë të pijshëm, për fshatrat vendore. Komuniteti mësoi për projektin e planifikuar vetëm kur kompania solli makineritë dhe filloi pastrimin e pyllit në vitin 2013-të. Kompania Teodor 2003 shpk, nuk ishte konsultuar me banorët përpara fillimit të punimeve, pavarësisht se skema e hidrocentralit e kufizonte aksesin e banorëve vendas për ujin dhe pakësimin e përdorimit të tij për vaditjen, kullotjen dhe rritjen e barit me të cilën ata kanë lidhur jetesën e tyre. Këto hapa në të vërtetë, bien ndesh me kërkesat mjedisore dhe sociale të BERZH-it. Banorët u ankuan për pakësimin e burimeve ujore, tek autoritetet vendore, ministritë e linjës dhe Avokati i Popullit, duke kërkuar që punimet për ndërtimin e HEC-it të ndaleshin. Si përgjigje banorëve iu tha se punimet kishin avancuar në një fazë të tillë sa ishte e pamundur ndryshimi i projektit. Në vitin 2014, banorët nisën një sërë protestash që përshkallëzuan në rrethimin e kampit të ndërtimit dhe arrestimin e protestuesve nga policia. Në ditën e tejkalimit të kostove dhe vonesave të projektit, investitori, kërkoi mënyra të tjera për të angazhuar banorët vendas. Megjithatë, mungesa e konsultimit të hershëm e ka çënuar procesin e besimit mes kompanisë dhe banorëve të prekur.</p>
Të dhëna kryesore	<p>Teodor 2003 shpk Kapaciteti i instaluar 8,385 Kwh, prodhimi i parashikuar 56,935,350 kwh. Sasia e ujit që do shfrytëzohet është 1m³/s. Projekti u miratua me VKM nr.556, datë 1.08.2003 dhe u ndryshua me VKM nr.123, datë 14.03.2007 i cili ndryshoi nga 6 HEC-e në 1 HEC.</p>
Burimi i konfliktit	<p>Ndarja e ujit – niveli i 1-rë i konfliktit Ndikimi mjedisor – niveli i 2-të i konfliktit</p>
Detaje të projektit dhe aktorët Zona e projektit	<p>HEC Ternova, është në pronësi të Teodor 2003 shpk (me pronar Faik Teodori (30%), Shefikat Ngjela (35%) dhe Albania Hydro Investment Holding (30%) dhe TEODOR 5%. Projekti ndodhet në fshatin Valikardhë në Zerqan Bulqizë.</p>
Niveli i investimit Konflikti dhe mobilizimi	<p>18.500.000 EUR Protestë rruge, bllokim rruge, konfrontim me policinë, peticion qeverisë, persona të arrestuar.</p>
Ndikimi i konfliktit	<p>Dokumentuar Ndikimi mjedisor: ndarja e ujit, humbja e peizazhit, devijim i ujit të Liqenit të Zi.</p>
Rezultati i konfliktit	<p>Potencial Mungesa e vaditjes ndikimi social-ekonomik. Ndërtuar Asnjë ndryshim institucional I pa suksesshëm pasi projekti u ndërtua</p>
Burime dhe materiale/Referenca	<ul style="list-style-type: none">- http://balkanrivers.net- http://shqiptarja.com/aktualitet/2731/kunder-hec-banoret-sulmojne-kompanine-200-mije-euro-dem-219098.html- NIPT K42301006L, Ekstrakt historik nga Qendra e Regjistrimit të Biznesit.

Fletë informuese 2:

Lufta për Zembrën Blu të Alpeve shqiptare.

Lugina e Valbonës.

Përshkrim	<p>Në janar 2016, organizata Toka zbulon rreth zhvillimit të një hidrocentrali në Parkun Kombëtar të Valbonës. Pas disa kërkimeve dhe pyetjeve, organizata dhe banorët vendas mësojnë rreth planeve për fillimin e punimeve për ndërtimin e 2 hidrocentraleve (Ceremi dhe Dragobi), të cilët së bashku etiketohen si Hidrocentrali i Dragobisë, me një kapacitet total prej 22.7 MW. Në shkurt 2016 u bë e ditur se projekti ishte pjesë e një skeme më të madhe me 4 HEC-e, prej 51 MW. Në mars 2016, pasi u njoftua nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit se nuk kishte projekte të tjera, banorët vendas mësuuan për kompaninë <i>Valbona Project Company</i> me 9 HEC-e të tjera ku shumica janë brenda parkut kombëtar. Gjithashtu, një kompani e tretë T-Plani shpk, po zhvillon një tjetër hidrocentral HEC T-Plani duke përdorur një HEC ekzistues. Në total, qeveria ka lëshuar 3 koncesione për zhvillimin e 14 HEC-eve. T-Plani nisi punimet në vitin 2013, ndërsa Dragobia Energy shpk, e cila ka në pronësi HEC-et e Dragobisë dhe Ceremit, filloi punimet në 21 shtator 2016 në mes të protestave dhe ankesave nga OSHC-të, aktivistëve, shkencëtarët, medias dhe profesorëve vendas e ndërkombëtar dhe komunitetit ndërkombëtar. OSHC-të dhe qytetarët kanë kryer një rishikim të plotë të dokumentacionit, licencave, studimeve mjedisore, lejeve dhe kanë gjetur në to:</p> <ul style="list-style-type: none">- Planifikim dhe dizajn të varfër të projektit,- Biodiversiteti i pa vlerësuar siç duhet,- Zhvillimi nuk ishte brenda afateve ligjore,- Pjesëmarrje publike e pamjaftueshme dhe jo efektive,- Asnjë konsultim me vendet fqinje.
Të dhëna kryesore	<p>Dragobia EnergyShpk Kapaciteti i instaluar është 22.7 MW dhe prodhimi i pritur është 26.900 kwh. Uji që do të shfrytëzohet është 7.15 m³/s dhe do të përdoret 150 ditë në vit. Projekti është me rrjedhje të lirë, i cili nënkupton se nuk do të ketë digë, ose ujëmbledhës dhe prodhimi i energjisë do të varet nga rrjedha sezonale e ujit. Projekti është i përbërë nga dy hidrocentrale të vegjël. I pari është në lumin e Ceremit, i cili është degëzim i Lumit të Valbonës dhe i dyti është në lumin Valbonë, afër fshatit të Dragobisë. Tubi i marrjes së ujit që do transportojë ujin nga tuneli në godinë do të jetë i fshehur në tokë, duke e bërë shumicën e projektit të padukshëm. Uji, do të devijohet 3,090 m në HEC-in e Ceremit dhe 271 m në HEC-in e Dragobisë. Me pas uji do të derdhet në lumë dhe do të vazhdojë rrjedhën normale.</p>
Burimi i konfliktit	<p>Ndikimi mjedisor dhe parku kombëtar – Niveli i 1-rë i konfliktit;</p> <p>Ndikimi mbi peizazhin dhe turizmin – Niveli i 2-të konfliktit;</p> <p>Devijim i ujit – Niveli i 3-të i konfliktit.</p>
Detajet e projektit dhe aktorët	<p>Kompania koncesionare Dragobi Energy shpk e cila menaxhon HEC Dragobi dhe HEC Ceremi është në pronësi të plotë të Gener – 2 shpk.</p>
Zona e projektit Niveli i investimit	<p>17.5 Milion EUR investim privat</p>
Aktorët kryesorë të angazhuar në konflikt	<ul style="list-style-type: none">- Organizata TOKA;- Grupimi i OSHC-ve “Të mbrojmë lumenjtë” i përbërë nga (INCA, Mileukontakt Shqipëri, Eco Albania, REC Shqipëri, EDEN, Ekolëvizja, Shoqata për Bujqësi Organike, Instituti për Politika Mjedisore, Rrjeti për Mbrojtjen e Natyrës, Illyria)¹⁷- OSHC-të Ndërkombëtare (WWF, RiverWatch, EuroNatur, Leeway Collective, Patagonia);- Shkencëtarët dhe komuniteti i profesorëve;- Banorët vendas.

¹⁷ http://help-cso.net/?page_id=448

Fletë informuese 2:

Lufta për Zembrën Blu të Alpeve shqiptare.


Lugina e Valbonës.

Konflikti dhe mobilizimi	<ul style="list-style-type: none"> - Më 11 prill, protestë e qytetarëve përpara Bashkisë Tropojë, duke kërkuar anulimin e hidrocentraleve dhe fokusimi te turizmi dhe mbrojtja e Luginës së Valbonës, - Prill 2016, letër pozicionimi nga WWF Adria rreth “Zhvillimit të Hidroenergjisë në Parkun Kombëtar të Valbonës, Shqipëri”, - Më 8 maj, vozitës të kayak-ëve në Valbonë protestuan kundra cunamit të digave që kërcënojnë lumenjtë e Ballkanit dhe Valbonën, të udhëhequr nga atleti Olimpik Slloven, Rok Rozman, - Më 20 maj në Tiranë u protestua para zyrës së Kryeministrit e mbështetur dhe nga komuniteti lokal i Luginës së Vjosës, - Mbledhja e peticionit elektronik e më shumë se 1,870 firmave, - 18 shkresa zyrtare, të dërguara nga grupimi “Të mbrojmë lumenjtë”, - Një rishikim i raportit të VNM-së, nga grupi i ekspertëve vendas për HEC Dragobinë, - Më 21 qershor 2016-të, nisin punimet për HEC-in e Dragobisë, - Më 29 tetor 2016-të, u organizua një koncert protestë në Valbonë, për mbrojtjen e luginës së Valbonës me këngëtares e njohura Elina Duni, Elda Zari dhe shumë aktivistëve, - Më 19 dhjetor 2016-të, u mbajt një protestë në Tiranë para Ministrisë së Energjisë nga grupimi “Të mbrojmë lumenjtë”, duke kërkuar informacion se cilat HEC-e do të anulohen nën moton “ Keni vendosur ta shkatërroni Valbonën”.
Ndikimi i konfliktit	<p>Potencial Ndikimi mjedisor: humbja e peizazhit, humbja e biodiversitetit, devijimi i ujit. Potencial Ndikimi socio –ekonomik: pakësimi i turizmit.</p>
Rezultati i konfliktit	<p>9 HEC-e, të kompanisë Valbona Energy Company janë anuluar.¹⁸ Ndërsa 3 HEC-e, do të vazhdojnë të ndërtohen sipas deklaratës publike të kryeministrit Rama, megjithatë, nuk ka asnjë dokument zyrtar që vërteton anulimin e tyre. Beteja vazhdon ende për anulimin e 3 HEC-eve të mbetura, përmes përpjekjeve diplomatike me qeverinë shqiptare dhe përgatitjeve për dërgimin në gjykatë të çështjes.</p>
Burime dhe materiale/Referenca	<ul style="list-style-type: none"> - Elba shpk, “Studim fizibiliteti i HEC-eve në Luginë të Valbonës: Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”; - WWF, Letër Pozicionimi: “Zhvillimi i Hidroenergjisë në parkun kombëtar të Luginës së Valbonës, Shqipëri”; - Jiří Dusík and Martin Smutný (2016), “Rishikim i raportit të ndikimit në mjedis për hidrocentralet e kaskadës së Dragobisë në rrethin e Tropojës”, WWA Adria. - http://gener2.al/business-lines/qarrishta-and-dragobia-hydropower-plant-2/ - Dokumente nga OSHC Toka, http://www.journeytovalbona.com/good/river-initiatives/ - http://www.reporter.al/lufta-per-zemren-blu-te-alpeve-shqiptare - http://www.balkanweb.com/site/masakra-ne-valbone-11-hec-e-ne-25-km/

¹⁸ Kryeministri Rama deklaroi publikisht nga Salla e parlamentit që 2 nga 12 HEC-e të lëshuara në Valbonë do të ndërtoheshin vetëm: Dragobia dhe Ceremi dhe Valbona (T-Plani).

Fletë informuese 3:

HEC Valbona (T-plani) devijon projektin teknik dhe përballet me protesta.

<p>Përshkrim</p>	<p>Në janar 2016, organizata Toka zbulon rreth zhvillimit të një hidrocentrali në Parkun Kombëtar të Valbonës. Në mars 2016, pas disa kërkimeve dhe pyetjeve pranë agjencive shtetërore (Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura), organizata Toka, e mbështetur nga grupimi "Të mbrojmë lumenjtë", mësojnë rreth një kompanie tjetër T-Plani shpk, që po ndërton një tjetër hidrocentral të quajtur HEC Valbona (T-plani i emërtuar sipas emrit të fshatit me të njëjtin emër, duke përdorur një HEC ekzistues i ndërtuar në vitin 1969). Megjithatë, Shoqata lokale Toka e mbështetur nga një grupim i shoqatave të tjera kombëtare, e ka kundërshtuar ndërtimin e këtij hidrocentrali, duke argumentuar se kompania ka ndërtuar një kanal të ri betoni, ka zgjeruar volumnin e marrjes së ujit, duke kundërshtuar se po shfrytëzon të njëjtën infrastrukturë të HEC-it ekzistues. HEC Valbona, nisi punimet në vitin 2013 dhe pothuajse i ka përfunduar ndërtimet. Protesta dhe ankesat e OSHC-ve, aktivistëve dhe shkencëtarëve, medias dhe profesorëve ndërkombëtarë kanë qenë konstante, si vazhdimësi e luftës kundër ndërtimit të HEC-ve në Luginën e Valbonës pa i ndarë ndërmjet hidrocentraleve individuale që po ndërtohen në Valbonë. Shoqëria civile ka kërkuar lejet dhe dokumentet e projektit për HEC Valbonën nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, që ka rezultuar e pasuksesshme për shkak të mungesës së dokumentacionit për projektin. Një ankesë u regjistrua nga Lex Ferenda në 22.12.2016, me Komisionerin për të Drejtën e Informimit, duke kërkuar kontratën koncesionare të HEC Valbonës, së bashku me 10-të kontrata të HEC-eve të tjera. Në kohën e shkrimit të raportit, kontrata akoma nuk është mundësuar.</p> 
<p>Të dhëna kryesore</p>	<p>T-Plani Shpk Kapaciteti i instaluar 2-4 MW. Projekti është me rrjedhje të lirë, i cili nuk ka ruajtje të ujit apo digë dhe prodhimi i energjisë do të varet nga rrjedhja sezonale e ujit. Projekti përbëhet nga tubacioni i marrjes së ujit nga Lumi Valbonë përmes një kanali devijues dhe më pas përcimi drejt godinës së hidrocentralit.</p>
<p>Burimi i konfliktit</p>	<p>Ndikimi mjedisor dhe parku kombëtar – niveli i 1-rë i konfliktit; Ndikimi i peizazhit dhe turizmi – niveli i 2- të i konfliktit; Devijimi i ujit – niveli i 3-të i konfliktit.</p>
<p>Detajet e projektit dhe aktorët</p>	<p>Kompania koncesionare T-plani shpk, është në pronësi të plotë të Flamur Buçpapaj</p>
<p>Zona e projektit Niveli i investimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Organizata TOKA; - Grupimi i OSHC-ve, "Të mbrojmë lumenjtë" i përbërë nga (INCA, Mileukontakt Shqipëri, Eco Albania, REC Shqipëri, EDEN, Ekolëvizja, Shoqata për Bujqësi Organike, Instituti për Politika Mjedisore, Rrjeti për Mbrojtjen e Natyrës, Illyria)¹⁹
<p>Aktorët kryesorë të përfshirë në konflikt</p>	<ul style="list-style-type: none"> - OSHC-të Ndërkombëtare (WWF, RiverWatch, EuroNatur, Leeway Collective, Patagonia);

Fletë informuese 3:

HEC Valbona (T-plani) devijon projektin teknik dhe përballlet me protesta.

Konflikti dhe mobilizimi	<ul style="list-style-type: none">- Më 11 prill, protestë e qytetarëve përpara Bashkisë Tropojë, duke kërkuar anulimin e hidrocentraleve dhe fokusimi te turizmi dhe mbrojtja e Luginës së Valbonës,- Prill 2016, letër pozicionimi nga WWF Adria rreth “ Zhvillimit të Hidroenergjisë në Parkun Kombëtar të Valbonës, Shqipëri”,- Më 8 maj, vozitës të kayak-ëve në Valbonë protestuan kundra cunamit të digave që kërcënojnë lumenjtë e Ballkanit dhe Valbonën, të udhëhequr nga atleti Olimpik Slloven, Rok Rozman,- Më 20 maj në Tiranë u protestua para zyrës së Kryeministrit e mbështetur dhe nga komuniteti lokal i Luginës së Vjosës,- Mbledhja e peticionit elektronik e më shumë se 1,870 firmave,- 18 shkresa zyrtare, të dërguara nga grupimi “Të mbrojmë lumenjtë”,- Një rishikim i raportit të VNM-së, nga grupi i ekspertëve vendas për HEC Dragobinë,- Më 21 qershor 2016-të, nisin punimet për HEC-in e Dragobisë,- Më 29 tetor 2016-të, u organizua një koncert protestë në Valbonë, për mbrojtjen e luginës së Valbonës me këngëtarët e njohura Elina Duni, Elda Zari dhe shumë aktivistëve, <p>Më 19 dhjetor 2016-të, u mbajt një protestë në Tiranë para Ministrisë së Energjisë nga grupimi “Të mbrojmë lumenjtë”, duke kërkuar informacion se cilat HEC-e do të anulohen nën moton “ Keni vendosur ta shkatërroni Valbonën”.</p>
Ndikimi i konfliktit	<p>Potencial Ndikimi mjedisor: humbja e peizazhit, humbja e biodiversitetit, devijimi i ujit.</p> <p>Potencial Ndikimi socio-ekonomik: pakësimi i turizmit.</p>
Rezultati i konfliktit	<p>9 HEC-e, të Valbona Energy Company pretendohet se janë anuluar ndërsa 3 HEC-e, do të vazhdojnë të ndërtohen sipas planit.</p> <p>Beteja vazhdon ende për anulimin e 3 HEC-eve të ngelura përmes përpjekjeve të forta diplomatike me qeverinë dhe masat e mundshme për dërgimin në gjykatë.</p>
Burimi dhe materile/Referncat	<ul style="list-style-type: none">- http://www.journeytovalbona.com/good/river-initiatives/- http://www.reporter.al/lufta-per-zemren-blu-te-alpeve-shqiptare- http://radionacional.al/sqarim-lidhur-me-ndertmin-e-tplani-hec-valbona-nga-xaje-sinani.

¹⁹http://help-cso.net/?page_id=448

Fletë informuese 4:

HEC Cërnaleva than mulli-të e ujit dhe thellon varfërinë e banorëve të Cërnalevës.

Përshkrimi	<p>Më 30 prill 2009 Ministria e Energjisë firmosi marrëveshjen konçesionare, nr.1447 rep. nr.166 kol, për ndërtimin e 4 hidrocentraleve: HEC Borje, HEC Oreshkë, HEC Cernaleva dhe HEC Cernaleve 1. Të gjitha hidrocentralet, ndodhen në rrethin e Kukësit. HEC Cernaleve 1, shfrytëzon ujin e përroit të Borjes dhe aktualisht është vënë në punë me një kapacitet prej 400 Kw, më vonë pritet të instalojë një kapacitet prej 2,950 kw. Kur filluan punimet, banorët vendas nuk ishin në dijeni të projektit, nuk ishin të informuar dhe as u pyetën për zhvillimin. Kjo çoi në një sërë protestash nga banorët e fshatit Cernaleve, duke pretenduar se përdorimi i pronave, tokave dhe kullotave të tyre nga ana e kompanisë, ishte bërë pa i pyetur fare. Më 12 tetor 2012, banorët vendas organizuan një tjetër protestë, e cila çoi në shkatërrimin e aseteve të kompanisë dhe arrestimin e 3 grave dhe një të mituri 15 vjeçar. Banorët vendas janë ankuar se kompania ka marrë gjithë ujin dhe mulliri i fshatit nuk funksionon prej kohësh, për të plotësuar nevojat e tyre jetike.</p>
Të dhëna kryesore	<p>Hidro Albania Energji shpk Kapaciteti i instaluar është 6.73 MW dhe prodhimi vjetor është 14,748 MWh për vitin 2014. Projekti u miratua sipas kontratës konçesionare nr.1447 rep nr.166 kol më datë 30.04.2009. Projekti përfshin HEC Borje, HEC Oreshkë, HEC Cernaleve dhe HEC Cernaleve 1. Hidrocentralet janë planifikuar me deviacion, duke devijuar ujin në kanale dhe më pas në godinën ku ndodhen turbinat.</p>
Burimi i konfliktit	<p>Ndarja e ujit – niveli i 1-rë i konfliktit</p> <p>Shkatërrimi i kullotave dhe bujqësisë – niveli i dytë i konfliktit</p>
Detajet e projektit dhe aktorët Zona e projektit Niveli i investimit Konflikti dhe mobilizimi	<p>HYDRO ALBANIA 27% dhe Kompania G.P.G 66%, Instituti Dekliada 7 %) Vlera e projektit 7, 79 Milion Lek. Projekti është në fshatin Cernaleve në komunën Zapod, Kukës. Banorët vendas të fshatit Cernaleve, media lokale.</p> <p>Protestë rruge, bllokim rruge, konfrontim me policinë, peticion qeverisë, 4 të arrestuar (3 gra dhe 1 i mitur)</p>
Ndikimi i konfliktit	<p>Potencial Ndikimi mjedisor; humbja e peizazhit, kullotat dhe pyjet janë shkatërruar.</p> <p>Dokumentuar Ndikimi socio-ekonomik: ndarja e ujit, mungesa e ujit vaditës.</p>
Rezultati i konfliktit	<p>Ndërtuar Asnjë ndryshim institucional I pasuksesshëm pasi projekti u ndërtua pa marrë në konsideratë nevojat lokale</p>
Burimi dhe materiale/referencat	<ul style="list-style-type: none">- http://telegrafi.com/shishtavec-konflikt-per-ndertimin-e-hec-it/- https://www.youtube.com/watch?v=Frl6edh6N0c- NIPT K984202020 – Ekstrakt historik i QKR për subjektin “Hidro Albania Energji shpk.

Fletë informuese 5:

HEC Mati 1, 2, 3 - Banorët kundra hidrocentralit;
kërcënon bujqësinë.

Përshkrimi	Më 21 janar 2012, Ministria e Energjisë nënshkroi një marrëveshje koncesionare me prot.nr.375, rep nr.203 kol me një bashkim kompanish (Riviera shpk; Energy Projekt; EHW shpk dhe Atlantik JStc) për ndërtimin e 8 hidrocentraleve në lumin Mat. Megjithatë, koncesioni iu shit grupit Enso Hydro Energy (90% e aksioneve) dhe më 14 maj 2016, kompania e krijuar për menaxhimin e kontratës koncesionare Mati Hydropower shpk kërkoi, një ndryshim kontrate, duke kërkuar rinovimin e afateve kohore për shkak të vonesave në marrjen e gjithë licencave, lejeve përkatëse dhe ndryshimin e projektit teknik nga 8 hidrocentrale në vetëm 3 hidrocentrale të emërtuar Mati 1, Mat 2 dhe Mat 3. Kompania <i>Mat Hydropower</i> , është në procesin e marrjes së lejeve por ata janë ndeshur me kundërshti të forta nga komuniteti vendas, në Bashkinë Klos për ndërtimin e hidrocentralit Mat 1. Konsultimi i parë publik, i planifikuar për 16 dhjetor 2016-të, u shndërrua në një protestë të fortë rruge, ku banorët argumentuan se hidrocentralet do të thanin lumin dhe kërcënonin bujqësinë dhe zhvillimin agrar në zonë, duke detyruar zhvendosjen e popullsisë. Kryetari i Bashkisë ka deklaruar publikisht se zëri i qytetarëve ka qenë i qartë në orientimin e qëndrimit zyrtar të bashkisë dhe vendimit të tij për zhvillimin e hidrocentraleve. Kryetari i Bashkisë, i ka kërkuar kompanisë të ndryshojë projektin teknik dhe të anulonte ndërtimin e tuneleve devijues të ujit, për shkak të ndikimit të madh në komunitet.
Të dhëna kryesore	Mati Hydro power sh.p.k Kaskada përgjatë lumit Mat, konsiston në 3 hidrocentrale dhe janë të vendosur në lumin Mat në afërsi të Bashkisë Klos. Projekti shfrytëzon një segment të lumit në lartësinë 350m deri 166.5m mbi nivel të detit me një sipërfaqe ujëmbledhëse rreth 500.7 km ² . Kaskada përbëhet nga një hidrocentral në një fazë të ndërmjetme presioni, e konsideruar si impiant me devijim. Prodhimi vjetor i parashikuar, do të jetë rreth 130 Gwh me kapacitet të instaluar prej 30 MW.
Burimi i konfliktit	Menaxhimi i ujit – niveli i 1-rë i konfliktit Devijimi i ujit - niveli i 2-të i konfliktit Ndikimi mjedisor – niveli i 3-të i konfliktit
Detaje të projektit Dhe aktorëve	Mati Hydropower Shpk Në pronësi të Enso Hydro Energy (90%)
Zona e projektit	Banorët lokal, media lokale
Niveli i investimit	
Konflikti dhe mobilizimi	Protesta rruge, letër ankesë për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.
Ndikimi i konfliktit	Potencial Ndikimi mjedisor: humbja e peizazhit humbja e biodiversitetit, devijimi i ujit
	Potencial Ndikimi socio-ekonomik: kërcënimi i prodhimit bujqësor, në kundërshti me planet e zhvillimit turistik.
Rezultati i konfliktit	Në fazë licencimi Asnjë ndryshim institucional E paditur
Burimet dhe materiale/Referencat	<ul style="list-style-type: none"> - http://www.ikub.al/ligje_category/16/08/04/per-miratimin-e-kontrates-shtese-te-koncesionit-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-0160.aspx?cookiesenabled=false - TV Bulqiza, "Protestë e banorëve të Klosit në lidhje me planet e kompanisë Mat Hydropower për ndërtimin e hidrocentraleve; 17 dhjetor 2016; http://www.tvbulqiza.al/klos-banoret-ne-proteste-kunder-ndertimit-te-hece-ve - http://www.oranews.tv/vendi/banoret-e-klosit-kunder-ndertimit-te-hec-eve-blokuan-rrugen/.

Fletë informuese 6:

HEC Peshku konflikt mbi pronësinë me banorët.

Përshkrim	Kompania Koka shpk, nisi procedurat për ndërtimin e HEC Peshk-ut që në vitin 2003 dhe në vitin 2007, përzgjedhi si partner Shijaku shpk për të vazhduar bashkërisht investimin për ndërtimin e hidrocentralit. HEC Peshku u ndërtua në pjesën veriore të Shqipërisë, në jug të fshatit Krastë, ndërmjet fshatrave Peshk dhe Gjon. Megjithatë në 15 shkurt 2016, gjatë dëshmisë së K.P, lidhur me aktivitetet e një grupimi kriminal, u zbulua një urdhër për vrasje, gjoja e porositur nga administratori i kompanisë së hidrocentralit lidhur me Koka shpk. Porosia në fjalë, kishte lidhje me konfliktin që ekzistonte për pronësinë e tokës ku ishte ndërtuar hidrocentrali, me një banor vendas. Referuar dhe burimeve në media, dëshmia u verifikua nga një kallëzim i depozituar në vitin 2010 nga pronari i tokës, ku akuzonte të njëjtin person të së njëjtës kompani. ²⁰
Të dhëna kryesore	Koka &Ergi Energy Peshku” shpk Projekti është 3.6 MW dhe prodhimi vjetor është 17.95 Gwh. Projekti prodhon energji, duke shfrytëzuar ujin e lumit Mat ndërmjet kuotave 709 m dhe 590 m me një devijim prej 2.2 km, që kalon në anën e djathtë të lumit. Vepra e marrjes së ujit është vendosur mbi urën e fshatit Peshk, në pikën ku dy degët e Përroit Lena dhe Përroit Thekna takohen për të formuar lumin Mat. Godina e hidrocentralit, është ndërtuar në krahun e djathtë të lumit përballë pikës ku Përroi Xixull takohet me lumin Mat. Projekti do të shfrytëzohet 185 ditë gjatë kohës së thatë dhe 236 ditë gjatë kohës së lagësht.
Burimi i konfliktit	Konflikt i pronës – niveli i 1-rë i konfliktit Menaxhim i ujit - niveli i 2-të i konfliktit Devijim i ujit – niveli i 3-të i konfliktit
Detaje të projektit dhe aktorët Zona e projektit Niveli i investimit	HEC Peshku është në pronësi të Koka shpk e 51% dhe Shijaku shpk me 49%. Investimi i projektit është rreth 5,500,000 euro. “Koka &Ergi Energy Peshk” shpk, është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më datë 27.06.2008 me NIPT K88027901B.
Konflikti dhe mobilizimi	Tentative vrasje i pronarit të tokës.
Ndikimi i konfliktit	Potencial Ndikimi mjedisor – S’ka të dhëna Potencial Ndikimi socio-ekonomik: çështje pronash
Rezultati i konfliktit	Ndërtuar Asnjë ndryshim institucional Në prodhim që prej 2012
Burimet dhe materialet/Referencat	<ul style="list-style-type: none"> - NIPT K88027901B - Ekstrakt historik nga QKR; - http://www.mapo.al/2016/02/biznesmeni-50-mije-euro-per-vrasjen-e-nje-pronari-tokash/1 - http://koka-shpk.com/web/energjitike/h-peshk/

²⁰ Eksperti nuk gjeti ndonjë të dhënë dhe nuk ishte në pozicion për të bërë verifikime për raportimin e medias për shkak të profilit të rastit konfliktual. Arsyja e prezantimit të rastit lidhet me rëndësinë e përmendjes së llojit të konfliktit i lidhur me hidrocentralet dhe pronësinë në përgjithësi.

Fletë informuese 7:

HEC Fani përballet me përplasjet nga komuniteti dhe protesta për tjetërsimin e tokës.

<p>Përshkrimi</p>	<p>Në vitin 2009, qeveria tenderoi koncesionin e Fanit të Madh dhe Fanit të Vogël në Pukë, rrethi i Mirditës për shfrytëzimin e kapaciteteve hidroenergjetike. Më 2 maj 2011, Ayen AS Energji nënshkroi kontratën e formës BOT nr. 5446 rep dhe nr. 1944 Kol me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë për ndërtimin dhe operimin e 3 hidrocentraleve me rrjedhje të lirë dhe një me digë përmes një koncesioni 35 vjeçar dhe kosto paraprake prej 142.5 milionë Euro. Më 20 dhjetor 2012, Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit aprovoi ndërtimin e hidrocentraleve në lumenjtë ë Fanit të Madh dhe të Vogël. Punimet nisën në vitin 2013 dhe priten të përfundojnë në mes të vitit 2017-të. Banorët vendas në Qafë-Mollë (rrethi i Mirditës) kanë protestuar kundra ndërtimit të HEC-it, para se të kryhet kompensimi i tokës së tyre. Gjatë protestave banorët kanë shkatërruar asetet e kompanisë, kanë bllokuar punëtorët e kompanisë të hyjnë në kantier dhe janë ndeshur me forcat e policisë disa herë. 6 persona janë arrestuar për shkak të protestave. Më 30 korrik 2014 për shkak të një aksidenti brenda në tunel, kanë humbur jetën 3 punëtorë (2 shqiptarë + 1 turk), për shkak të shkatërrimit të tunelit gjatë ndërtimit. Si pasojë, 200 punëtorët e kompanisë të mbështetur dhe nga fshatarët e zonës kanë protestuar për kushtet e sigurisë në punë.</p> <p>Gjithashtu, banorët vendas në fshatin Gojan në Pukë janë përballuar në konflikt me partnerin tjetër shqiptar Ayen AS Energy, që çoi në shpërthimin e HEC-it Gojan duke shkaktuar një dëm prej 3 milionë EUR sipas deklaratave të kompanisë. Sipas komunikatave të policisë, dy persona të paidentifikuar kanë lidhur rojën e HEC-it dhe vendosën tritolin që shkaktoi shpërthimin.</p>															
<p>Të dhëna kryesore</p>	<p>Ayen AS Energji shpk është një bashkim kompanish nga kompania turke Ayen Enerji Co, Inc, AyeI Elektrik Uretim Sanayi Ve Ticaret A.Ş., Fahrettin Amir dhe partnerëve shqiptarë AS Energy me 82%+8%+1% + 9% të aksioneve respektivisht.</p> <p>Dy hidrocentralet e parë, Gojan dhe Gjegjan do të përdorin ujin e sipërm të Fanit të Madh. Ndërsa dy të tjerët, Peshqesh dhe Ura e Fangut do të shfrytëzojnë kapacitetet hidroenergjetike të Fanit të Madh dhe të Fan-it të Vogël. Fani i Vogël, devijon brenda Fanit të Madh afër fshatit Shkoret, në komunën e Oroshit. Tre hidrocentralet e parë, FHP1, FHP2, dhe FHP3 janë me rrjedhje të lirë, ndërsa i katërti është me liqen dhe digë. Projekti i kaskadës së Fanit të Madh dhe të Vogël ka një kapacitet total, të instaluar prej 110.56 MW dhe një prodhim të parashikuar prej 367.640 Mwh ose ekuivalenti i 7% të kapacitetit aktual gjenerues në Shqipëri dhe 8% i energjisë së furnizuar në vend në vitin 2012. Projekti ka 8 turbina francis që lidhen së bashku me 3 faza dhe gjeneratorë të sinkronizuar.</p>															
<p>Grafiku i marrë nga Kompania Ayen për qëllime studimore.</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>no'lu Proje</th> <th>K₀</th> <th>E_A</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1 no'lu Proje</td> <td>12.25 MW</td> <td>46.77 GWSa</td> </tr> <tr> <td>2 no'lu Proje</td> <td>6.55 MW</td> <td>24.68 GWSa</td> </tr> <tr> <td>3 no'lu Proje</td> <td>27.94 MW</td> <td>92.90 GWSa</td> </tr> <tr> <td>4 no'lu Proje</td> <td>63.81 MW</td> <td>212.29 GWSa</td> </tr> </tbody> </table>	no'lu Proje	K ₀	E _A	1 no'lu Proje	12.25 MW	46.77 GWSa	2 no'lu Proje	6.55 MW	24.68 GWSa	3 no'lu Proje	27.94 MW	92.90 GWSa	4 no'lu Proje	63.81 MW	212.29 GWSa
no'lu Proje	K ₀	E _A														
1 no'lu Proje	12.25 MW	46.77 GWSa														
2 no'lu Proje	6.55 MW	24.68 GWSa														
3 no'lu Proje	27.94 MW	92.90 GWSa														
4 no'lu Proje	63.81 MW	212.29 GWSa														
<p>Burimi i konfliktit</p>	<p>Tjetërsim i tokës – niveli i 1-rë i konfliktit, Punësimi lokal – niveli i 2-të i konfliktit, Mjedisi dhe burimet ujore – niveli i 3-të i konfliktit.</p>															
<p>Detaje të projektit dhe aktorët</p>	<p>Ayen AS Energji</p>															
<p>Zona e projektit</p>	<p>Rrethi i Mirditës Banorët lokalë nga Qafë-Molla</p>															
<p>Niveli i investimit</p>	<p>Media lokale 13,600,000,000 –142.5 milion euro.</p>															

Fletë informuese 7:

HEC Fani përballlet me përplasjet nga komuniteti dhe protesta për tjetërsimin e tokës.

Ndikimi i konfliktit	Dokumentuar dhe/ose potencial Ndikimi mjedisor: burimet ujore dhe pyjore të dëmtuar, shkatërrimi i peizazhit dhe devijimi i ujit.
	Dokumentuar Ndikimi socio-ekonomik: tjetërsimi i pronës, ndarja e ujit dhe vaditja e tokës.
Rezultati i konfliktit	Pjesërisht e ndërtuar, në ndërtim. Asnjë ndryshim institucional E pasigurtë. Projekti është në ndërtim e sipër.
Burime dhe materiale/Referencat	<ul style="list-style-type: none">- https://www.asp.gov.al/index.php/17-shqip/lajmet-e-fundit/9329-nga-seksioni-per-hetimin-dhe-parandalimin-e-krimeve-u-arrestuan-ne-flagrance-2-shtetas-gjeneralitetet-e-te-cileve-per-arsye-hetimi-nuk-jepen-per-vepen-penale-shkaterrimit-te-prones-me-eksploziv-kryer-ne-bashkepunim;- http://www.ayenas.al/project-description;- http://24-ore.com/?p=8631- http://shqiptarja.com/aktualitet/2731/puk-shp-rthim-tritoli-n-hec-in-e-gjegjanit-autor-t-lidh-n-rojen-357845.html- Ekstrakt i kompanisë AS Energy në AKR.

Fletë informuese 8:

HEC Vinjoll: Konflikti për përdorimin e ujit përshkallëzohet në viktima.

Përshkrimi	Më 2 gusht 2009, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Energjisë nënshkroi një kontratë koncesionare me Komp Energy shpk, për ndërtimin e hidrocentraleve Vinjoll, Hurdhas 1, Hurdhas 3 dhe Hurdhas 3. HEC-et ndodhen në Vinjoll, në zonën e Kurbin. Punimet e ndërtimit nisën në vitin 2012-të dhe banorët vendas kanë protestuar për ndërtimin e hidrocentralit në Vinjoll, për shkak të mungesës së ujit për bujqësi dhe vaditje, duke qenë se përdorej i njëjti burim uji. Protesta të shumta u organizuan në qershor të vitit 2014-të nga fshatarët duke argumentuar se devijimi i ujit ndikonte drejtpërsëdrejti në ekonomitë e tyre familjare të lidhura me bujqësinë. Më parë në 24 mars 2014, një shpërthim tritolu u bë në fshatin Gallat (afër Vinjollit), lidhur me një konflikt prone ndërmjet koncesionar-it të hidrocentralit dhe një banori vendas. Më 2 prill 2016, babai i pronarit të hidrocentralit, vrau një banor vendas nga Vinjollit për shkak të konfliktit të zgjatur, lidhur me pronësinë e tokës ku u ndërtua hidrocentrali. Në të vërtetë konfliktet e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Kurbin lidhur me HEC-in në fjalë kanë qenë të shumta, kur në 02.01.2015 një banor vendas, devijoi ujin nga tubacionet e hidrocentralit në kanalet vaditëse dhe u dënua për vetëgjyqësi. Kompania, shfrytëzoi burimet e Gurrës së Vinjollit dhe përmes devijimit me tuba çeliku, e dërgon ujin në godinën e hidrocentralit dhe më pas gjithë hidrocentralin njëri pas tjetrit. Banorët vendas, janë të irrituar dhe në tension konstant për shkak të ndërtimit të këtij HEC-i dhe menaxhimit të ujit.
Të dhëna kryesore	Komp Energy Shpk Kapaciteti i instaluar është 4.6 MW dhe prodhimi i parashikuar është 13.3 Gwh.
Burimi i konfliktit	Devijimi i ujit – niveli i 1-rë i konfliktit Menaxhimi i ujit - niveli i 2-të i konfliktit Të drejtat e pronës - niveli i 3-të i konfliktit
Detaje të projektit dhe aktorët	Komp Energy shpk është në pronësi të Fitim Lalës (51%) një banor vendas me banim në New York dhe 49% të aksioneve të ndara me Michal Morciniec (qytetar Zvicerian).
Zona e projektit Niveli i investimit	Projekti i Vinjollit HEC Hurdhas 1,2,3 është rreth 1.459.854 EUR. Banorët e Vinjollit.
Konflikti dhe mobilizimi	Protestë rruge, padi, vetëgjyqësi
Ndikimi i konfliktit	Dokumentuar Ndikimi mjedisor: devijimi i ujit, të drejtat e ndarjes ë ujit. Potencial Ndikimi social-ekonomik: ndikimi në bujqësi.
Rezultati i konfliktit	Ndërtuar Asnjë ndryshim institucional I pa suksesshëm pasi hidrocentrali u ndërtua.
Burime dhe materiale/Referencat	<ul style="list-style-type: none"> - Ekstrakt historik nga QKR. - http://www.panorama.com.al/konflikti-per-rrugen-e-hec-it-te-vinjollit-plumba-50-vjecarit-ne-kurbinhttps://www.youtube.com/ëatch?v=oufp-1egjauhttps://www.youtube.com/ëatch?v=1ufmgzq3mxu - https://www.asp.gov.al/index.php/17-shqip/lajmet-e-fundit/8962-mbi-vrasjen-e-ndodhur-ne-kurbin.

Fletë informuese 9:

HEC Gurshpatë kryeson listën e protestave për shkak të drejtave të ndarjes së ujit.

Përshkrimi


Në vitin 2009 u themelua kompania Gurshpatë Energji shpk për të menaxhuar një kontratë koncesionare, për ndërtimin e HEC Gurshpatë 1&2, e nënshkruar me Ministrinë e Ekonomisë dhe Industrisë në vitin 2008-të. Deklarata mjedisore, u aprovua në vitin 2010-të dhe punimet e projektit nisën në vitin 2012-të. Banorët vendas në fshatin Gurshpatë dhe fshatin Polis, kanë protestuar për faktin se kanë qenë të painformuar për këtë hidrocentral, nuk kanë marrë ndonjë njoftim për ndërtimin e hidrocentralit. Banorët kanë protestuar në mënyrë konstante, për mungesën e ujit për vaditje, por nuk janë marrë në konsideratë. Si pasojë, një sërë protestash u organizuan që prej vitit 2013. Në 17 nëntor 2014, 8 persona u arrestuan, me akuzën e kundërshtimit dhe goditjes së forcave të policisë, gjatë protestave në Korrik të 2014-ës, në fshatin Polis (Librazhd). Protestuesit kërkuan ndalimin e punimeve për hidrocentralin Gurshpatë 1, pasi po mernte ujin e pijshëm dhe ujin vaditës. Fshati nuk ka ujësjellës dhe shumica përdorin puse.

Më 10 gusht 2013, rreth 600 banorë të fshatit Polis dhe fshatarë të tjerë, protestuan kundër ndërtimit të hidrocentralit Gurshpatë 2, duke u ankuar se projekti do ta merrte gjithë ujin që përdorej për bujqësi dhe rrezikonte jetesën e tyre. Ata kanë akuzuar, se nuk janë informuar fare për ndërtimin e projektit dhe planet e zhvillimit të tij. Në përgjithësi, banorët kanë organizuar rreth **180 protesta që nga viti 2013-të deri në vitin 2015-të**, lidhur me HEC Gurshpatë 1&2. Më 20 dhjetor 2013, banorët tentuan dhe depozituan një padi në prokurorinë e rrethit Librazhd, me argumentin e thyerjes së kontratës nga ana e kompanisë, po nuk u mor asnjë masë. Banorët vendas, janë mbështetur nga Shoqata Egnatia dhe rrjeti i emërtuar ECIM (Ekolëvizija, Egnatia, Milieukontakt, Sëbashku dhe AJMI), të cilët janë takuar me Prefektin dhe autoritetet e tjera vendore, për të paraqitur shqetësimin e shkatërrimit të parkut kombëtar, Shebenik-Jabllancë nga ndërtimi i hidrocentraleve të shumta (rreth 95 nga të cilët 45 në park. HEC Gurshpatë 1, është aprovuar nga Bashkia në vitin 2006-të, me kushtet që hidrocentrali të zhvendoset 15 metra, larg kanalit vaditës të fshatit. Në të vërtetë HEC Gurshpata 1, ka krijuar ndikim dhe për peshkatarët e zonës, pasi nuk ka lënë fare ujë në shtrat të lumit. Ndërsa, sipas pretendimit, Gurshpatë 2 nuk është aprovuar nga Këshilli Bashkiak. Banorët, të cilët organizuan protestat, u lanë për muaj të tërë në burg pa dalë para gjyqit, u keqtrajtuar dhe dolën me dëmtime nga burgu.

Të dhëna kryesore

Gurshpate Energy SHPK

Kompania koncesionare, u krijua për menaxhimin e kontratës BOT nr. rep 349 col 50, më datë 30.02.2009..



Burimi i konfliktit

Devijim i ujit – niveli i 1-rë i konfliktit

Menaxhimi i ujit – niveli i 2-të i konfliktit

Ndikimi mjedisor – Niveli i 3-të i konfliktit

Fletë informuese 9:

HEC Gurshpatë kryeson listën e protestave për shkak të drejtave të ndarjes së ujit.

Detaje të projektit dhe aktorët Zona e projektit Niveli i Investimit	Aksionarët janë Mar Energy (51%) dhe ARJANA C (49%). ²¹ . Të dyja kompanitë janë në pronësi të njëjtit person. Gurshpatë 1&2 ka një kapacitet prodhues prej 1.67 MW Vlera e kontratës ishte 176.738.773 Lek, (EUR 1.3 Milion) nënshkruar më 26.03.2009. NIPT Nr. K914250170 <ul style="list-style-type: none">- Banorët vendas,- OSHC lokale dhe kombëtare,- Media lokale,- Ekspertë dhe profesorë,- Politikanë (Deputetë).
Konflikti dhe mobilizimi	Protestë rruge, padi, peticione, përplasje me policinë, persona të arrestuar. Bllokim i aseteve të kompanisë.
Ndikimi i konfliktit	Dokumentuar/Vëzhguar Ndikimi mjedisor: shkatërrimi i peizazhit, humbja e biodiversitetit devijim i ujit. Vëzhguar/dokumentuar Ndikimi socio-ekonomik: ndikimi në bujqësi, pronësia e tokës, mungesa e ujit, dëmi ekonomik dhe gjobat financiare.
Rezultati i konfliktit	Ndërtuar Asnjë ndryshim institucional I pasuksesshëm pasi hidrocentrali u ndërtua
Burime dhe materialet/Referencat	http://www.forum-al.com/shoëthread.php?t=33009 http://www.klsh.org.al/web/pub/ministrin_e_ekonomis_441_1.pdf http://www.arkivalajmeve.com/Nje-HEC-i-dyte-ne-perroin-e-Gur-Shpatit-protestojne-banoret-Ska-uje.1047421181/ ; http://investigim.al/en/hec-et-e-librazhdit-qe-futen-ne-lufte-banoret-me-shtetin/ Zela G, "Raporti final për projektin me Ekolëvizjen për evidentimin e ndikimeve nga ndërtimi i HEC-ve në Rrethin e Librazhdit, gusht 2015


²¹ Në fillim aksionerët ishin ITALPRO KHTS & Arjana-C, or më vonë ItalproKHTSi shiti aksionet e saj te MarEnergy.

Fletë informuese 10:

HEC Rrapun 1&2:

Uzurpim i tokës dhe erozion i lartë.

Përshkrimi	<p>Të drejtat e koncesionit për HEC Rrapun 1 dhe 2, u fituan nga kompania C&S Construction Energy, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 717 datë 14.05.2008. Hidrocentralet shfrytëzojnë ujin e lumit Rrapun përmes devijimit duke marrë ujin në tuba dhe sërish e derdhin në lumë. Ndërtimi i hidrocentralit Rrapun, në Lumin Rrapun ka qenë i shoqëruar me protesta, nga banorët e fshatit Tokëz të komunës Darëz. Banorët kanë ngritur shumë ankesa lidhur me shkatërrimin e lumit Rrapun duke marrë gjithë ujin përmes tubave dhe duke shkaktuar humbje të faunës, erozionin e tokës, dhe çështje të pronësisë. Banorët e fshatit Tokëz ishin të parët që nisën protestat në rrethin e Librazhdit duke iu adresuar autoriteteve lokale, deputetëve të zonës dhe Qeverisë për shkak të kërcënimit që i kanosej ekonomisë së tyre nga zhvillimi i këtyre hidrocentraleve. Njëkohësisht një peticion me 118 firmëtarë i është dorëzuar nën-Prefektit të Qarkut Mehmet Bicaku në 12.12.2013, dhe një padi është regjistruar në prokurorinë e rrethit gjyqësor dhe një padi civile lidhur me çështje pronësie është regjistruar në Gjykatën e Rrethit. Për më tepër kompania koncesionare, ka bllokuar rrugën e kalimit për fshatarët përmes vendosjes së një porte dhe një roje të palicencuar, pa shenjë dalluese dhe autoritet përkatës. Organizatat lokale, media lokale dhe banorët vendas “merren në pyetje” për çdo kalim në rrugën publike në të kundërt nuk lejohet kalimi. Kjo praktikë është kthyer në një fenomen normal në zonën e Librazhdit në shumë hidrocentrale.</p>
Të dhëna kryesore	<p>C&S Construction Energy Kompania e krijuar për menaxhimin e kontratës koncesionare të formës BOT. Koncesioni i HEC Rrapun 1&2 i është dhënë kompanisë C&S Construction me VKM nr.717 datë 14.05.2008. Kapaciteti i instaluar është 8.250 Kw dhe prodhimi vjetor përafërsisht 44,650,000 kwh.</p>



Fletë informuese 10:

HEC Rrapun 1&2:

Uzurpim i tokës dhe erozion i lartë.

Burimi i konfliktit	Ndikimi mjedisor dhe parku kombëtar – niveli i 1-rë i konfliktit Devijimi i ujit - niveli i 2-të i konfliktit
Detaje të projektit dhe aktorët Zona e projektit Niveli i investimit	Menaxhimi i ujit – niveli i 3-të i konfliktit HEC Rrapun 1&2 janë në pronësi të kompanisë C&S Construction e administruar nga Arjan Cukaj. Shuma e investimit sipas kontratës është 6,140,000 Euro. Fshatarët e fshatit Togëz-it, fermerët vendas, Organizata lokale Egnatia, Ekolëvizja, rrjeti ECIM.
Konflikti dhe mobilizimi	Protestë rruge, padi, peticion drejtuar: Prefekt-it, Ministrin të Mjedisit, deputetë-ve dhe Kryeministrit.
Ndikimi i konfliktit	Potencial Ndikimi mjedisor: shkatërrimi i peizazhit, humbja e faunës dhe florës, shkatërrimi i shtratit të lumit dhe erozioni i tokës. Potencial Ndikimi socio-ekonomik: turizmi, sistemi i vaditjes dhe ndjenja e përkatësisë së vendit dhe mjedisit.
Rezultati i konfliktit	Ndërtuar Asnjë ndryshim institucional I pasuksesshëm
Burimi dhe materiali/referencat	<ul style="list-style-type: none">- NIPT - K81914029T, ekstrakt nga QKR i kompanisë C&S Construction,- http://investigim.al/en/abuzimet-me-lejet-e-hec-eve-koncesionet-qe-po-shkaterrojne-lumenjte/,- Zela G, "Raporti final për projektin me Ekolëvizjen për evidentimin e ndikimeve nga ndërtimi i HEC-ve në Rrethin e Librazhdit", Gusht 2015 http://www.gazetatema.net/ëeb/2016/08/02/janullatos-peruron-nje-hec-ne-elbasan-financim-i-kishes-orthodokse/- http://energja.al/tag/banoret/page/2/,- http://www.gazetatema.net/ëeb/2016/08/02/janullatos-peruron-nje-hec-ne-elbasan-financim-i-kishes-orthodokse/,- http://energja.al/tag/banoret/page/2/,- Vizita në terren gjatë dhjetorit 2016-të dhe takim me OSHC-të lokale.

Fletë informuese 11:

HEC Rrapun 3, 3A&4:


Zhvillim i kaskadës: Uji humbet në tuba çeliku.

Përshkrimi

Më 11 shtator 2009 Këshilli i Ministrave vendosi ti jepte koncesionin e Rrapun 3,3A&4 bashkimit të kompanive C&S Construction, Ferrar shpk dhe Gjickuria shpk (fituese e koncesionit). Pas ndryshimeve në pronësinë e koncesionit, aksionet u transferuan të C&S Construction (2%) dhe Ekovepra shpk (98%). Më 5.05.2015, konsorciumi i ri regjistroi kompaninë e re për menaxhimin e koncesionit të emërtuar C&S Energy shpk. Në fakt Ekovepra shpk është në pronësi të plotë nga Energjia Ekologjike shpk dhe kjo e fundit në pronësi të plotë nga Kisha Autoqefale Ortodokse e Shqipërisë. Banorët vendas i referohen hidrocentralit thjesht si "hidrocentrali i Janullatos", më së shumti nga ceremonia e inaugurimit ku Kryepeshkopi mori pjesë në 2 gusht 2016.

Ndërtimi i hidrocentralit Rrapun 3,3A,4 fillimisht u planifikuan si projekt me rrjedhë të lirë, pa krijuar shumë ndikim në mjedis por më vonë e ndryshuan projektin dhe krijuar një digë për mbledhjen e ujit në mes të lumit Rrapun dhe përmes një tubi të fshehur rreth 2.4 km të gjatë e çojnë ujin nga diga te godina e HEC-it Rrapun 4. Ky projekt, është shoqëruar me protesta nga banorët e fshatit Togëz nga Njësia Administrative Darëz. Banorët, kanë ngritur shumë ankesa lidhur me shkatërrimin e lumit Rrapun duke i marrë gjithë ujin përmes tubave, duke shkaktuar humbje të faunës, erozionin e tokës, dhe çështje të pronësisë. Banorët e fshatit Tokëz ishin të parët që nisën protestat në rrethin e Librazhdit, duke iu adresuar autoriteteve lokale, deputetëve të zonës dhe qeverisë për shkak të kërcënimit që i kanosej ekonomisë së tyre, nga zhvillimi i këtyre hidrocentraleve. Njëkohësisht një peticion, me 118 firmëtarë i është dorëzuar nën Prefektit të Qarkut Mehmet Bicaku në 12.12.2013, një padi është regjistruar me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor dhe një padi civile, lidhur me çështje pronësie është regjistruar në Gjykatën e Rrethit.

Organizatave vendore, siç është Egnatia, po kryejnë monitorime të rregullta të zbatimit të kontratës dhe lejeve mjedisore dhe rezultojnë se nuk ka ujë ekologjik ose rrjedhë biologjike në shtretin e lumit. Nuk ka një kalim për peshqit dhe flora është shkatërruar. Erozioni i tokës ka filluar të shfaqet, e dëshmuar dhe gjatë vizitës në terren të ekspertit në dhjetor të 2016-ës. Gjatë vizitës në terren, kompania punonte me 1/3 e kapacitetit të vet në dhjetor të 2016-ës, ku supozohet të funksiononte me kapacitet të plotë. Mungesa e ujit të mjaftueshëm për potencialin e instaluar ka bërë që kompania të depozitojë ujin e më shumë se një lumi duke filluar nga Qarrishta, Gurakuq dhe Përroi i Lunikut. (Shiko skemën e përgatitur nga eksperti në vendngjarje)



Të dhëna kryesore

C&S Energy shpk

Është kompania e krijuar për menaxhimin e kontratës koncesionare të formës BOT nr.2854 rep, nr.383 kol i datës 11.09.2009. Aksionarët janë Ekovepra shpk dhe C&S Construction shpk. Ekovepra rezultojnë të jetë në pronësi të Energjia Ekologjike shpk dhe kjo e fundit në pronësi të Kishës Autoqefale Ortodokse Shqiptare. Kapaciteti i instaluar është 9.9 MW dhe një prodhim i parashikuar prej 42.9 Gwh. Kompania ka ndërtuar një digë me lartësi 10m mbi lumin Rrapun me 4 porta dhe me një volum prej 60 mijë m³. Liqeni i krijuar mbledh ujin nga lumi i Qarrishtës, Përroi i Lunikut dhe Përroi i Gurakuqit dhe e çon përmes tubacionit nën tokë drejt në godinën e hidrocentralit.²² Godina ka 3 turbina Francis 3.3 MW secila dhe kompania ka deklaruar se kanë kryer 411.850 m³ gërmime dhe mbushje dheu.

Fletë informuese 11:

HEC Rrapun 3, 3A&4:

Zhvillim i kaskadës: Uji humbet në tuba çeliku.

Burimi i konfliktit	Devijimi i ujit - niveli i 1-rë i konfliktit Pronësia dhe tërmetet nga shpërthimet brenda tunelit – niveli i 2-të i konfliktit Menaxhimi mjedisor – niveli i 3-të i konfliktit
Detaje të projektit dhe aktorët Zona e projektit Niveli i investimit	HEC Rrapun 3,3A dhe 4 janë në pronësi të Kishës Autoqefale Ortodokse të Shqipërisë përmes kompanisë Ekovepra shpk. Investimi i projektit shkon në 790,361,249 All. <ul style="list-style-type: none">- Fshatarët e Togëz-it,- Fermerët vendas,- Shoqata lokale Egnatia,- Ekolëvizja,- Grupimi “Të Mbrojmë Lumenjtë”.
Konflikti dhe mobilizimi	Protesta rruge, padi, letër ankese, peticion drejtuar Prefektit, Ministrit të Mjedisit, Deputetit dhe Kryeministrit.
Ndikimi i konfliktit	Dokumentuar Ndikimi mjedisor: shkatërrimi i peizazhit, humbja e faunës dhe florës, shkatërrimi i shtratit të lumit dhe erozioni i tokës.
Rezultati i konfliktit	Potencial Ndikimi socio –ekonomik: turizmi, sistemi i vaditjes dhe ndjenja e përkatësisë së banorëve.. Ndërtuar Asnjë ndryshim institucional Jo i suksesshëm pasi projekti u ndërtua pa marrë në konsideratë alternativat e komunitetit
Burime dhe materiale/Referencat	<ul style="list-style-type: none">- NIPT - K92402005Q, ekstrakti nga QKR i kompanisë C&S Energy shpk;- http://investigim.al/en/abuzimet-me-lejet-e-hec-eve-koncesionet-qe-po-shkaterrojne-lumenjte- Zela G, “Raporti final për projektin me Ekolëvizjen për evidentimin e ndikimeve nga ndërtimi i HEC-ve ne Rrethin e Librazhdit, gusht 2015,- http://www.gazetatema.net/ëeb/2016/08/02/janullatos-peruron-nje-hec-ne-elbasan-financim-i-kishes-orthodokse/- http://energja.al/tag/banoret/page/2/,- http://www.gazetatema.net/ëeb/2016/08/02/janullatos-peruron-nje-hec-ne-elbasan-financim-i-kishes-orthodokse/,- http://energja.al/tag/banoret/page/2/,- Vizita në terren dhe takime me shoqatat lokale në dhjetor 2016;- Takim me ekipin e shoqatës Egnatia në 3 dhjetor 2016.

²²HEC Rrapun 2 i përket një kompanie koncesionare tjetër dhe në pronësi të njëjtit aksionar të C&S Construction I cili gëzon dhe 2% të C&S Energy shpk.

Fletë informuese 12:

HEC Kalivaçi një konflikt i tejzgjatur si dëshmi i sistemit të dështuar qeverisës.

Përshkrim	<p>Në vitin 1997, qeveria e Shqipërisë, nënshkroi një koncesion të formës BOT me Becchetti Energ Group (BEG SPA) për ndërtimin e Hidrocentralit të Kalivaçit mbi Lumin Vjosë, për një periudhë 30 vjeçare. HEC Kalivaçi, supozohej të kishte një kapacitet prej 100 MW dhe do të prodhojë 350 Gwh. Projekti planifikohej të përfundonte në vitin 2000 dhe është inauguruar dhe shtyrë në të njëjtën kohë, nga çdo qeveri e radhës. Kontrata koncesionare, u ndryshua në vitin 2000 dhe në vitin 2007-të, kur Banka Gjermane Deutsche Bank AG bleu 45% të aksioneve të projektit. Megjithatë disa vite më vonë si Qeveria Shqiptare dhe Banka Gjermane, hapën një padi në gjykatë kundër BEG SPA, për shkelje të kontratës. Aktualisht punimet e ndërtimit janë pezulluar sërish, (ashtu si kanë qenë për 4 vitet e fundit) dhe deri tani janë përfunduar vetëm 30% e punimeve. Megjithatë sipas planeve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë HEC Kalivaçi është vetëm një nga 8 hidrocentralet e mundshëm të mëdhenj që planifikon të ndërtojë në Lumin Vjosë.</p> <p>Sipas BEG SPA, punimet kishin nevojë për një studim të kujdesshëm rreth tipareve morfologjike në zonë dhe ERM Itali u kontraktua për të kryer raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, sipas standardeve të Bankës Botërore. ERM Itali, analizoi me kujdes florën, faunën dhe situatën e zonës dhe kreu pyetësorë dhe intervista me qëllim të sillte në vëmendje ndikimin më të vogël të mundshëm për banorët e zonës.</p> <p>HEC Kalivaçi, ka krijuar një sërë problemesh likuiditeti dhe mos pagesa me nën-kontraktorët dhe punonjësit vendas të cilat kanë dalë në protestë. Banorët dhe punonjësit vendas, kanë organizuar tre protesta në 4 tetor, 9 tetor dhe në 13 nëntor 2013 ku janë arrestuar dhe 4 persona nga policia.</p>
Të dhëna kryesore	<p>Becchetti Energy Group (BEG SPA)</p> <p>Projekti është afërisht 100 MW dhe supozohet të prodhonte rreth 350 Gwh energji elektrike. Kalivaçi është një hidrocentral me digë, dy turbina dhe do të përmbyste një sipërfaqe të konsiderueshme të tokës, pranë fshatrave të shtrirë përgjatë luginës së Vjosës. Projekti është i gjithi italian dhe ka përfshirë disa nga kompanitë më të rëndësishme të vendit për ndërtimin. Deri sot janë përfunduar 30% të punimeve.</p>
Burimi i konfliktit	<p>Ndikimi mjedisor – niveli i 1-rë i konfliktit</p> <p>Menaxhimi i ujit - niveli i 2-të i konfliktit</p>
Detajet e projektit dhe aktorët	235 milion euro.
Zona e projektit	
Niveli i investimit	Banorët vendas dhe punonjësit e firmës.
Konflikti dhe mobilizimi	<p>Në 8 maj 2014 një protestë u organizua nga OSHC-të (Të ruajmë Zembrën Blu të Evropës) dhe u lëshua një komunikatë për shtyp;</p> <p>Artikuj në media;</p> <p>Protestë në rrugë, bllokim rruge, peticione dhe kërkesa.</p>
Ndikimi i konfliktit	<p>Dokumentuar</p> <p>Ndikimi mjedisor: shkatërrimi i peizazhit, menaxhimi i ujit.</p> <p>Potencial</p> <p>Ndikimi socio-ekonomik: përmbytja e tokës</p>
Rezultati i konfliktit	<p>Pezulluar</p> <p>Asnjë ndryshim institucional</p> <p>E pasigurt. Projekti u ndalua për shkak të mungesës financiare të kompanisë.</p>
Burime dhe materiale/Referencat	<ul style="list-style-type: none"> - Ekstrakt historik i kompanisë në QKR - http://shqiptarja.com/mobile/artikull_old.php?IDNotizia=189821&NomeCategoria=&Titolo=hec-i-kaliva-it-pun-tor-t-n--protest-se-s--39-u-paguan-4-n--arrest&IDCategoria=1&reply=372295

Fletë informuese 13:

HEC Poçem shkon në gjykatë.

Përshkrimi	<p>Më 30 maj 2016, qeveria e Shqipërisë ka miratuar koncesionin për bashkimin e dy kompanive turke <i>Ayen Enerji Şirketi Anonymous</i> dhe <i>Çinar-San Hafriyat Nakliyat Turizm Insaat San Ve TicLtd.Sti</i> për të ndërtuar një hidrocentral të madh, me digë në lumin Vjosë. Sipas studimeve të shoqatës Eko Albania, ekzistojnë 38 HEC-e të parashikuara në gjithë basenin e lumit Vjosa, nga ku 6 hidrocentrale të planifikuara në pjesën greke vetëm 1 është ndërtuar, hidrocentrali me digë i Pigait. 31 hidrocentrale janë të planifikuara në territorin e Shqipërisë: 8 diga janë planifikuar përgjatë trungut të lumit Vjosë ndërsa 23 HEC-e shtesë në degëzimet e lumit Vjosë; 4 prej të cilëve janë përfunduar dhe janë në prodhim dhe 4 të tjerë janë në ndërtim e sipër. Projekti i Poçem-it, është pjesë e këtij plani të madh dhe parashikon një digë prej 50 m të lartë i cili do të ndikojë jo vetëm një prej pjesëve më të vlefshme të Vjosës por do të ketë dhe ndikime të mëdha të përmbytjeve në pjesën e poshtme të digës. Projekti i Poçem-it, është aktualisht duke u përballuar me një padi në Gjykatën Administrative si pasojë e mos informimit, Deklaratës Mjedisore, Raportit të VNM-së të cilat pretendohet se janë mbajtur për më shumë se 7 muaj të fshehta sipas OSHC-e vendore. Pas marrjes së një kopje të raportit të VNM-së në shtator 2016-të, një grup me ekspertë vendas përgatitën një raport analitik të VNM-së. OSHC-ja lokale Eko Albania e mbështetur nga organizatat ndërkombëtare si River Watch dhe Euronatur janë duke lobuar për deklarimin e Vjosës si një zonë “pa hidrocentrale”, duke kundërshtuar planet e ndërtimit në lumë. 7 protesta dhe më shumë se 70 artikuj në media/komunikata shtypi janë prodhuar për gjithë luginën e lumit Vjosë , duke përfshirë dhe HEC Poçem. Sipas, informacioneve zyrtare, raporti i VNM-së i është paraqitur publikut në 28 shkurt 2015 në Fier, por komuniteti lokal dhe qeveria lokale që preken nga ky projekt nuk janë informuar fare për këtë projekt dhe kanë protestuar duke u deklaruar kundër projektit.</p> <p>Sipas banorëve vendas dhe kryetarëve të bashkive përkatëse projekti përmbyt 2,500 ha tokë, ullishtë, pemëtore dhe zhvendos një numër të madh banorësh dhe efekti kumulativ është shumë herë më i madh pasi lë pa tokë një krahinë të madhe.</p>
Të dhëna kryesore	<p>Ayen Enerji Şirketi Anonymous dhe Çinar-San Hafriyat Turizm Insaat San Ve TicLtd.Sti Kapaciteti i instaluar është 102.2 MW dhe prodhimi i parashikuar është 3,668 GWH. Diga e hidrocentralit do të jetë 50m e lartë dhe gjatësia e saj prej 200m. Madhësia e liqenit do jetë 23.5 km².</p>
Burimi i konfliktit	<p>Përmbytjet e tokës – niveli i 1-rë i konfliktit Peizazhi - niveli i 2-të i konfliktit Papunësia nga përmbytja – niveli i 3-të i konfliktit</p>
Detajet e projektit dhe aktorët Zona e projektit Niveli i investimit	<p>160.1 milion euro. Banorët vendas, administratorët dhe bashkitë përkatëse, kryetarët e fshatrave, media lokale, OSHC-të lokale dhe ndërkombëtare, shkencëtarët dhe fermerët.</p>
Konflikti dhe mobilizimi	<p>Protestë rruge, studim alternativ i VNM-së, angazhim mediatik, rishqyrtim i studimit nga ekspertë dhe profesorë, padi në gjykatë.</p> <p>Kronologjia e konfliktit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Më 5 shkurt 2016, OSHC-të protestuan kundër HEC Poçem-it pasi u hapën ofertat e tenderit nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë,- Më 10 shkurt 2016, OSHC-të protestuan në konferencën HydroTech Albania kundër HEC Poçem-it dhe HEC-eve të planifikuara për ndërtim në Vjosë,- Më 13 maj 2016, në kuadër të Turit Ballkanit të Lumenjve, 500 persona të ndryshëm nga Evropa vozitën në shenjë proteste në Luginën e Vjosës. Turit u udhëhoq nga Rok Rozman në kuadër të fushatës “Ruani zemrën blu të Evropës” në 16 lumenj në 6 vende në 35 ditë,- Më 18 maj 2016, një flotila protestoi në Qesarat afër HEC Kalivaç-it. Vozitës të kayakëve, Ulrike Lunacek (Deputete e parlamentit të BE) dhe Delegacioni i BE-së në Tiranë vozitën nga Qesarat-i në urën e Poçem-it (vendi i digës së planifikuar të Poçem-it). Banorët dhe komuniteti vendas iu bashkuan gjithashtu.- Më 20 maj 2016, u mbajt një protestë në Tiranë para Kryeministrisë për anulimin e gjithë HEC-eve në Vjosë dhe në Valbonë,- Më 8 qershor 2016 shkencëtarët vendas dhe të huaj firmosën një memorandum ku kërkonin një moratorium 3 vjeçar për Luginën e Vjosës dhe një VNM të saktë për HEC Poçem,- Më 14 qershor 2016 banor vendas nga fshati Kutë bllokuan rrugën nacionale Levan-Tepelenë,- Më 25 qershor 2016 banorë të fshatit Kutë protestuan sëbashku me banorë të Luginës së Valbonës para zyrës së Kryeministrisë në Tiranë,

Fletë informuese 13:

HEC Poçem shkon në gjykatë.

	<ul style="list-style-type: none">- Më 8 shtator 2016 disa sllovenë protestuan në Slloveni ndërsa Kryeministria Rama ishte për vizitë në një aktivitet,- Në nëntor 2016, 2000 banorë të Kutës firmosën një peticion ku i kërkonin Kryeministrit të anulonte koncesionin e Poçem-it,- Më 4 nëntor 2016 banorë nga Kuta dhe Sevaster (komunitetet e prekura nga të dyja anët e lumit) protestuan sëbashku me OSHC-të, qeverinë vendore dhe deputetë të zonës. Njëkohësisht u bllokua dhe rruga nacionale si shenjë proteste,- Më 2 dhjetor 2016, shoqata Eko Albania dhe OSHC-të ndërkombëtare RiverWatch dhe Euronatur depozituan një padi në gjykatën administrative të Tiranës kundra HEC Poçem.
Ndikimi i konfliktit	<p>Potencial Ndikimi mjedisor: shkatërrimi i peizazhit, humbja e biodiversitetit, përmybtjet.</p> <p>Potencial Ndikimi socio-ekonomik: pakësimi i turizmit, humbja e bujqësisë dhe ekonomisë bujqësore, zhvendosja e popullsisë.</p>
Rezultati i konfliktit	Licencuar Asnjë ndryshim institucional Në proces
Burime dhe materiale/Referencat	<ul style="list-style-type: none">- http://balkanrivers.net- Fletë Informuese e Hidrocentralit të Poçem-it, përgatitur nga Euronatur dhe RiverWatch, Eco Albania 2016.- http://balkanrivers.net/sites/default/files/Prominent%20Supporters.pdf- http://www.ecoalbania.org/228-scientists-from-33-countries-support-europes-last-wild-river/- http://everything.plus/HEC_pocem/CqycP-fDj34.video- Padi e përgatitur për HEC Poçem dhe depozitur në Gjykatën Administrative të Tiranës, Dhjetor 2016.

Fletë informuese 14:

HEC Lengarica rrezikon monumentin e natyrës Kanioni i Lengaricës dhe parkun kombëtar.

Përshkrim	HEC Lengarica, është një hidrocentral i llojit me rrjedhje të lirë i cili është ndërtuar në pjesën e poshtme të lumit Lengarica, në rrethin e Përmetit, Prefektura e Gjirokastrës. Është i vendosur në një terren malor të pjerrët, në zonën e Banjave Termale në lartësinë e 410 m mbi nivelin e detit, rreth 7 km nga Lumi Vjosa. Projekti është i bashkë financuar nga Fondi për Rritje të Gjelbër, Fondi për Facilitet Teknik (huadhënësi) dhe IFC (20% - 6 Milion EUR). Projekti ka qenë i diskutueshëm duke qenë i vendosur brenda parkun kombëtar Hotovë Dangëlli (deklaruar me VKM nr.1631, datë 17.12.2008). Lumi i Lengaricës, është i karakterizuar nga një kanion mbresëlënës 7 km i gjatë dhe 80 m i thellë, i cili është emërtuar si monument natyror në vitin 1970. Për shkak të ujit me temperaturë të ulët dhe shtratit të lumit të pasur me zhavorr, Lengarica shërben si bazë shumimi për shumë specie peshqish. Për më tepër, 8 burimet termale janë të vendosura përgjatë lumit që tërheqin qindra turistë çdo vit. Ndërtimi i hidrocentralit të tretë, shkaktoi tharjen e përkohshme të ujërave termale në fillim të tetorit të vitit 2014. Si rezultat, qindra qytetarë dolën në rrugë të Tiranës duke kërkuar ndalimin e punimeve. Në atë kohë, Ministri i Mjedisit premtoi të ngrinte një grup pune si reagim ndaj protestës. Për këtë arsye Ministria e Mjedisit e refuzoi fillimisht lejen mjedisore në 4 tetor 2011 por e lëshoi në 24 janar 2012. OSHC-të dhe aktivistët mjedisorë kanë protestuar në forma të ndryshme kundra projektit dhe kanë apeluar të gjitha instancat shtetërore (Ministrinë e Mjedisit, Energjisë, Kryeministrinë). Shumë shoqata kombëtare dhe ndërkombëtare u mobilizuan për të deklaruar lumin e Vjosës si park kombëtar, pa diga dhe hidrocentrale. Por ndërtimet përfunduan në vitin 2015-të.
Të dhëna kryesore	Lengarica &EnergyShpk Kapaciteti i instaluar është 8,900 kw dhe prodhimi i parashikuar është 28.4 Gwh. Uji që duhet të shfrytëzohet është 7.15m ³ dhe do të përdoret vetëm 137 ditë/vit. Projekti përbëhet nga një kanal i marrjes së ujit rreth 13 m i lartë dhe 60 m i gjatë, rreth 4 km tunel (i veshur me beton 2.4m i gjerë dhe 4m i lartë), një dekanues prej beton për grumbullimin e ujit që vjen nga tuneli), një tub presioni rreth 3.7 km, godina e hidrocentralit 8.9 MW dhe rreth 6.5 km linjë transmetimi 35 kv për në stacionin e Përmetit. Godina e hidrocentralit ndodhet në veri të fshatit Petran rreth 2 Km nga lumi Vjosë.
Burimi i konfliktit	Ndikimi mjedisor dhe parku kombëtar – niveli i 1-rë i konfliktit Menaxhimi i ujit – niveli i 2-të i konfliktit Devijimi i ujit – niveli i 3-të i konfliktit
Detaje të projektit dhe aktorët Zona e projektit Niveli i investimit	Legarica&Energy shpk është në pronësi të Enso Hydro GmbH, Austri (100%), e cila e bleu nga Hasi Energyspk në vitin 2012.
	<ul style="list-style-type: none"> - Eko Albania, aktivistë vendas, qeverisja vendore, Qendra për Drejtësi dhe Solidaritet (Iliakondi); - OSHC-të ndërkombëtare (BankWatch, Euronatur, RiverWatch)
Konflikti dhe mobilizimi Ndikimi i konfliktit	Peticione, letër ankese, raporte, protesta rruge, padi Potencial Ndikimi mjedisor: shkatërrimi i peizazhit, kërcënimi ndaj burimeve termale, humbja e biodiversitetit, devijimi i ujit. Potencial Ndikimi socio-ekonomik: pakësimi i turizmit.
Rezutati i konfliktit	Ndërtuar Asnjë ndryshim institucional Jo i suksesshëm pasi projekti u ndërtua dhe prokuroria e pushoi çështjen
Burime dhe materila/Referencat	<ul style="list-style-type: none"> - http://balkanrivers.net/en/key-areas/vjosa-river - IFC Regjistri i Projekteve; http://ifcextapps.ifc.org - Hidrocentrali i financuar nga banka Botërore kërcënon Kanionin e Lengaricës; http://www.reporter.al/hidrocentrali-financuar-nga-banka-boterore-kercenon-kanionin-e-lengarices - http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-greens-rally-against-€orld-bank-financed-poëer-plant - Sikorova. K. dhe Gallop. Pippa. 2015, "Financimi i hidrocentraleve në zonat e mbrojtura në Europën Juglindore" Euronatur dhe Bankwatch, Dhjetor 2015. - E.Mazreku (2016), - Pushim i çështjes Lengarica, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, depozituar më 24 qershor 2016

Fletë informuese 15:


HEC Bënça & Tepelena: trashëgimia kulturore dhe mjedisore e kërcënuar.

Përshkrimi

Më 6 qershor 2009 Ministria e Energjisë nënshkroi një kontratë koncesionare me kompaninë Ferar shpk për ndërtimin e Hidrocentralit Bença dhe Hidrocentralit Tepelena. Të dy HEC-et janë 7 MW (3 MW + 4 MW) dhe do të ndërtohen si projekt me rrjedhje të lirë duke përdorur një tunel me deviacion. Në të vërtetë, qeveria ka licencuar ndërtimin e 8 hidrocentraleve ndaj 4 kompanive koncesionare: HEC Meshanik, HEC Guva, HEC Driza 1 & 2, HEC Lekdush/Progonat, HEC Bença e Sipërme, HEC Bença, HEC Tepelena. Të gjithë hidrocentralët janë të vendosura në Luginën e Bënçës, Progonat-it dhe Kanionet e Nivicës, që janë pjesë e Luginës së Vjosës. Lugina e Bënçës, me një gjatësi 26 km është e shtrirë ndërmjet Trushnicës dhe Buzës së Bredhit. Është një luginë mbresëlënëse e cila është formuar nga Gurra e Progonatit dhe Përrenjtë e Nivicës. Banorët vendas janë shumë krenarë për natyrën dhe trashëgiminë kulturore që kanë. Lugina e Bënçës nuk është një zonë e mbrojtur me ligj, por në fakt është një ekosistem i veçantë, i kombinuar me një peizazh mahnitës, që mund të jetë një zonë kryesore e një parku kombëtar të ardhshëm i Luginës së Vjosës. Nga ana tjetër, në zonë ka shumë monumente të mbrojtura dhe në veçanti në afërsi të veprës së marrjes së ujit për HEC-in Bença. Kanioni i Nivicës ka status si Monument Natyre, njësoj si Ujëvarat e Progonatit, Tarracat Erozive të Bënçës, dhe monumenti kulturor i Akuadaktit të Ali Pashës.

Specifikisht, ndërtimi i HEC Bënçës dhe HEC Tepelens në pronësi të kompanisë Ferrar Energy shpk kanë filluar punimet në prill 2013-të, pa leje mjedisore të cilën e morën vetëm në shtator 2013-të. Procesi i konsultimit u bë në gusht 2013-të (pasi kishin filluar punimet e ndërtimit), në një situatë të paqartë duke prezantuar një tjetër projekt me digë dhe rezervuar i cili do krijonte punësim, një liqen të vogël, industri peshkimi dhe aktivitete rekreative sportive. Megjithatë, projekti u ndryshua nga 2 HEC-e në vetëm 1, pa bërë asnjë konsultim dhe informim. Projekti i ri, do ta marrë ujin përmes tubacioneve dhe kanaleve dhe një tunel me deviacion sërish në godinën e hidrocentralit duke shkaktuar tharje të shtratit dhe ndryshim të ekosistemit për më shumë se 5 km të gjatë. Banorët vendas kanë kundërshtuar ndërtimin e këtij HEC-i dhe kanë protestuar disa herë në afërsi të kantierit të ndërtimit. Ata, e kanë çuar zërin dhe pranë institucioneve vendim-marrëse pasi sipas tyre janë mashtruar në lidhje me këtë projekt.

Shqetësimi kryesor i tyre është i lidhur me ndryshimin e ndjesisë dhe krenarisë kulturore dhe tradicionale e lidhur me luginën, lumin natyror dhe peizazhin e Bënçës. Marrja e ujit përmes tubacioneve dhe tuneleve do ta ndryshojë plotësisht potencialin e tyre turistik.



Skema e HEC-ëve Luginë e Bënçës
Përgatiti: E.Qëndro

Të dhëna kryesore

FerarEnergyShpk

Kapaciteti i instaluar është 5,405 KW dhe prodhimi i pritur është 41,669 milion kwh. Uji që do të shfrytëzohet është 7.71m³ dhe do të përdoret gjatë gjithë vitit duke respektuar rrjedhën ekologjike gjatë stinës së thatë. Projekti konsiston në kanalin e marrjes së ujit duke përdorur kanalin ekzistues vaditës, një dekadues për grumbullimin e ujit dhe presionin, një tunel me deviacion, tubin e presionit, godina e hidrocentralit dhe linjat e transmetimit për në stacionin e Tepelens. Godina e hidrocentralit është e vendosur në periferi të qytetit të Tepelens.

Burimi i konfliktit

Ndikimi mjedisor - niveli i 1-rë i konfliktit
Devijimi i ujit - niveli i 2-të i konfliktit
Menaxhimi i ujit - Niveli i 3-të i konfliktit

Detaje të projektit dhe aktorët

Ferar Energy shpk. Është në pronësi të Ferid Sukaj 100%.

Fletë informuese 15:

HEC Bënça & Tepelena: trashëgimia kulturore dhe mjedisore e kërcënuar.

Detaje të projektit dhe aktorët Zona e projektit Niveli i investimit	<p>Ferar Energy shpk. Është në pronësi të Ferid Sukaj 100%.</p> <p>Kosto totale e projektit është 675.221.200 Lek (rreth 5 milion Eur)</p> <ul style="list-style-type: none">- Eco Albania dhe 13 OSHC kombëtare (REC, EDEN, Milieukontakt, Ajmi, INCA, Ekolevizja, SHBO, EPER, ACERC, etj);- Banorët lokalë, shkencëtarët, RiverWatch dhe Euro natur.
Konflikti dhe mobilizimi	<p>Protestë rruge, letër ankese, deklarata, dalje mediatike, rishikim VNM-je Kronologjia e konfliktit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Gjatë 2014 një sërë letra ankesash ia janë dërguar qeverisë nga banorët e Bënçës,- Më 29 prill 2015 u organizua një protestë në kantierin e HEC Bënçës. Protesta u organizua nga banorët vendas mbështetur nga Përmeti, Selencia me moton kundër ndërtimit të HEC-it në lumin e Bënçës dhe luginën e Vjosës,- Në mars 2015 u firmos një peticion nga banorët e Luginës së Vjosës nga Përmeti, Selencia dhe banorët vendas të Bënçës drejtuar Kryeministrit,- Në korrik 2015 u nënshkrua një deklaratë nga 13 OSHC duke kërkuar anulimin e ndërtimit të HEC-it në Bënçë dhe Vjosë dhe iu dorëzua Kryeministrit,- Më 6 qershor 2015 u organizua një koncert proteste në Tiranë kundra ndërtimit të HEC-eve në luginën e Vjosës, me pjesëmarrjen dhe të grupit e iso polifonisë së Bënçës,- Më 17 maj 2016 vozitës të kayak-ve lundruan në lumin e Bënçës si pjesë e Turit Ballkanik të Lumenjve.
Ndikimi i konfliktit	<p>Potencial Ndikimi mjedisor: shkatërrimi i peizazhit, kërcënimi i vlerave natyrore, humbja e biodiversitetit, devijimi i ujit.</p> <p>Potencial Ndikimi socio-ekonomik: kërcënimi i turizmit dhe krenarisë dhe identitetit kulturor.</p>
Rezultati i konfliktit	<p>Punimet kanë ndalur përkohësisht Asnjë ndryshim institucional I pasigurt pasi projekti është pezulluar për më shumë se një vit.</p>
Burime dhe materiale/Referencat	<ul style="list-style-type: none">- http://balkanrivers.net/en/key-areas/vjosa-river- Qendra Kombëtare e Biznesit, ekstrakt historik i kompanisë Ferrar <i>shpk</i>, i aksesuar në 22 dhjetor 2016;- Ferrar Shpk, - raporti për vlerësimin e ndikimit në mjedis, përgatitur nga Invictusshpk, 2013.- Përshkrim mjedisor i burimeve natyrore të Luginës së Bënçës, dhe ndikimi i punimeve dhe funksionimi i HEC-eve në shtratin e lumit.- MM, Leja Mjedisor, Tipi B, lëshuar në 6.09.2013 nr.1449

Fletë informuese 16:

Kanionet e Nivicës dhe potenciali turistik i kërcënuar nga zhvillimi i paplanifikuar.

Përshkrimi

Më 6 shtator 2013 Ministria e Energjisë dhe Industrisë nënshkroi një marrëveshje koncesionare për ndërtimin e hidrocentralit Driza 1. Hidrocentrali është planifikuar si një projekt me devijim dhe ndodhet në Kanionet e Nivicës, rrethi i Tepelenës. HEC Driza 1 është akoma në procesin e marrjes së licencave (referuar një përgjigje dërguar nga Ministria e Energjisë si përgjigje nga kërkesa e dërguar nga Lex Ferenda në 12.12.2016 nr. prot.6807). Autoritetet vendore në Tepelenë janë kundra ndërtimit të HEC-it bazuar në ndikimet negative që ka në kërcënimin e zhvillimit turistik. Kryetari i Bashkisë i ka dërguar një numër shkresash qeverisë qendrore për ta anuluar koncesionin e hidrocentralit, por nuk ka gjetur mbështetje. HEC Driza 1, akoma nuk ka marrë leje aprovimi nga Bashkia Tepelenë për ndryshimin e fondit pyjor dhe kullosor me qëllim fillimin e punimeve, gjë e cila ka shkaktuar një sërë problematikash dhe konfliktesh. Agjencia Kombëtare e Turizmit, ka filluar një program për promovimin dhe zhvillimin e eko-turizmit në fshatin Nivicë duke shfrytëzuar bukuritë natyrore, eko-sistemin e paprekur dhe mënyrën tradicionale të jetesës në zonë, duke u fokusuar në vlerat e Kanionit të Nivicës, Kalasë së Nivicës me zbulimet arkeologjike ilire (vendin e shenjtë Pagan). Intelektualët e zonës, kanë ngritur shumë shqetësime me deputetët e zonës të cilët janë deklaruar se do ta anulojnë hidrocentralin, megjithatë MEI nuk ka marrë ndonjë nismë për anulimin apo zgjidhjen e konfliktit.



Të dhëna kryesore

Kendrevic Energyshpk

Kapaciteti i instaluar është 4,208 Kw. Sasia e ujit që do të shfrytëzohet është 4.5m³. Hidrocentrali do të shfrytëzojë ujin në kuotat +388m mbi nivelin e detit pasi uji të dalë nga hidrocentrali HEC Guva. Njëkohësisht do të mbledhë ujërat e përroit të Nivicës në lartësinë +382.9 m mbi nivelin e detit, përroitin e Salarisë në 390.36m. Projekti do të ketë kanale devijuese rreth 4.6 km, një dekadues presioni, tub presioni rreth 2605.5 mm, godinën e hidrocentralit në kuotat 255m. Lartësia e tubit të presionit është 119.55m. Linjat e transmetimit të energjisë të cilat do të ndërtohen do të lidhen me nënstacionin e Kuçit dhe unazën e jugut në 35kv.

Fletë informuese 16:

Kanionet e Nivicës dhe potenciali turistik i kërcënuar nga zhvillimi i paplanifikuar.

Burimi i konfliktit	Ndikimi mjedisor dhe natyror - niveli i 1-rë i konfliktit Peizazhi dhe turizmi - niveli i 2-të i konfliktit Prishja e vlerave arkeologjike - niveli i 3-të i konfliktit
Detaje të projektit dhe aktorët Zona e projektit Niveli i investimit	Kendrevic Energy shpk Gerti-Metal shpk & Everest shpk janë aksionarët fillestarë por më vonë aksionet ndryshuan dhe zotërohen plotësisht nga Gert-Metal shpk.
Konflikti dhe mobilizimi Ndikimi i konfliktit	349,864,5021 Lek (2.5 milion euro) Letër ankese, deklaratë nga OSHC-të, protestë. Potencial Ndikimi mjedisor: shkatërrimi i peizazhit, humbja e biodiversitetit, devijimi i ujit. Potencial Ndikimi socio-ekonomik: kërcënimi i turizmit.
Rezultati i konfliktit	Nuk është ndërtuar Nuk ka ndryshime institucionale Projekti është në fazë licencimi
Burime dhe materile/Referencat	<ul style="list-style-type: none">- http://newsbomb.al/index.php/aktualitet/item/29563-nje-hec-ne-nivice-kundershton-termet-peci-por-ministria-e-kultures-jep-ok-pavaresisht-trashegimnise- http://rtsh.al/lajme/hec-et-ne-kurvelesh/- Anulimi i HEC Driza 1, informohet nga Deputeti Fatmir Toçi në Komisionin Parlamentar të Medias, 9 shkurt 2016; http://rtsh.al/lajme/anullohet-ndertimi-i-nje-hec-i-mbi-kanionet-e-nivices/- B.Tare, "Një hidrocentral në Nivicë", Gazeta Dita, 6 mars 2016; http://www.gazetadita.al/nivica-e-kurveleshit-mes-historise-bukurise-natyrore-dhemarrezise-shteterore/

**STUDIM
VLERËSUES**

RASTET E KONFLIKTEVE UJORE TË LIDHURA
ME ZHVILLIMIN E HIDROENERGJISË NË SHQIPËRI

